



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9 regjistër (JR)  
Datë 19.07.2018

Nr. 11 i vendimit  
Datë 22.05.2019

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Luan Daci</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 22.05.2019, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 9/2018 (JR), datë 19.07.2018, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 22, datë 07.06.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 22, datë 07.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Edmond Islamaj dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Edmond Islamaj, i cili bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit prej vitit 1992 e në vijim ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë. Subjekti i rivlerësimit Edmond Islamaj i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor<sup>1</sup>, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht deklaratën e pasurisë<sup>2</sup>, deklaratën për kontrollin e figurës<sup>3</sup>, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional<sup>4</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
  - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
  - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
  - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
  - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

<sup>1</sup> Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>2</sup> Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 31.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2017.

<sup>3</sup> Dorëzuar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar më datë 28.01.2017.

<sup>4</sup> Dorëzuar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë më datë 28.01.2017, provuar kjo sipas Raportit të KLD-së “Për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj”, me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.11.2017 (f. 2 e raportit).

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit përcaktoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë, të plotë dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, dhe se nuk ka informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Për rrjedhojë, konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj për vazhdimin e detyrës.
5. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 22, datë 07.06.2018.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni me vendimin nr. 22, datë 07.06.2018, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Lartë. [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

**8.1** *Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, nga vlerësimi i provave të marra gjatë hetimit administrativ, rezultoi se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe personat e lidhur me të, si dhe në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.*

**8.2** *Në lidhje me kontrollin e figurës, nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara nga neni Dh i Aneksit të Kushtetutës. Për subjektin e rivlerësimit, konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.*

**8.3** Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, në analizë të raportit të vlerësimit të kryer nga KLD-ja, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti, Komisioni vlerëson se mangësitë e konstatuara në vlerësimin profesional janë formale dhe nuk janë të asaj shkalle sa të cenojnë aftësitë profesionale të gjyqtarit. Për sa më sipër, relatori i çështjes, pasi hetoi raportin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe denoncimet, nuk gjeti indicie apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit dhe propozoi për subjektin e rivlerësimit, z. Edmond Islamaj, cilësimin “i aftë” profesionalisht.

### **III. Shkaqet e ankimit**

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 11.07.2018, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 22, datë 07.06.2018, për subjektin e rivlerësimit Edmond Islamaj, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke pretenduar se procesi i hetimit të Komisionit për këtë kriter nuk është i plotë, ka mangësi dhe, për rrjedhojë, në gjendjen që janë aktet, nuk mund të arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

10. Komisioneri Publik kërkoi marrjen në shqyrtim të shkaqeve të ngritura në ankim, kryerjen e një hetimi të plotë për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe, në përfundim të gjykimit nga ana e Kolegjit, në zbatim të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 59 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik në ankimin e tij kërkoi në mënyrë alternative:

° ndryshimin e vendimit nr. 22, datë 07.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;  
ose:

° lënien në fuqi të vendimit nr. 22, datë 07.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

11. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurive paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**11.1** Mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni lidhur me kontrollin e pasurisë së paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, të llojit “kullotë”, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup>, nr. pasurie {\*\*\*}, ZK nr. {\*\*\*}, vendndodhje në {\*\*\*}/Kavajë, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se Komisioni nuk kishte hetuar në mënyrë të plotë lidhur me këto fakte:

(i) çmimin e blerjes së pasurisë, i cili është më i ulët se çmimet e referencës, i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për zonën në të cilën ndodhet pasuria në fjalë;

(ii) afatin shumë të shkurtër midis dy transaksioneve të njëpasnjëshme të tjetërsimit të kësaj pasurie (shitësi i pasurisë së paluajtshme rezultoi, sipas Komisionerit, se e ka regjistruar pasurinë për herë të parë, në emër të tij, në datën 04.02.2015, dhe e ka tjetërsuar atë në vijim, në datën 26.03.2015).

**11.2** Mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni lidhur me kontrollin e tri pasurive të paluajtshme në pronësi të personit të lidhur (bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit) me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, lagjja {\*\*\*}, Durrës, me këto të dhëna:

(i) “apartment”, me sipërfaqe 141,13 m<sup>2</sup>, nr. pasurie {\*\*\*}, ZK nr. {\*\*\*};

(ii) “njësi”/ambient tregtar, me sipërfaqe 55m<sup>2</sup>, nr. pasurie {\*\*\*}, ZK nr. {\*\*\*};

(iii) “garazh”, me sipërfaqe 16 m<sup>2</sup>, nr. pasurie {\*\*\*}, ZK nr. {\*\*\*};

– për të cilat Komisioneri Publik pretendoi se Komisioni nuk kishte hetuar në mënyrë të plotë në drejtim të: (i) burimit të krijimit të këtyre tri pasurive të paluajtshme; (ii) mospërputhjeve në të dhënat e dokumenteve hipotekore të dorëzuara nga subjekti në cilësinë e dokumenteve provuese, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (*vetting*) dhe dokumentacionit përkatës që është përcjellë nga ZVRPP Durrës, sipas kërkesës së Komisionit në kuadër të hetimit administrativ, lidhur me datën dhe numrat hipotekorë të regjistrimit të veprimeve juridike që kanë kaluar të drejtën e pronësisë së këtyre pasurive të paluajtshme në emër të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit dhe penaliteteve eventuale të vonesës në regjistrim; si dhe (iii) ekzistencës së kontratës për furnizimin me energji elektrike të një prej pasurive në fjalë (apartamentit të banimit), e cila rezultoi të jetë lidhur në emër të subjektit të rivlerësimit dhe jo të bashkëjetueses së tij, madje edhe para datës së fitimit prej saj të pronësisë mbi pasurinë në fjalë.

**11.3 Verifikimi nga Komisioni i saktësisë së deklaramit, lidhur me dy pasuritë e paluajtshme në përdorim (pa titull) të personit të lidhur (bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit), të llojit “garsonierë”, me sipërfaqe 32 m<sup>2</sup> secila, me vendndodhje te “{\*\*\*}”, Durrës, për të cilat Komisioneri Publik pretendoi se, që nga momenti për të cilin është pohuar se këto pasuri janë në përdorim të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit (viti 2010-2011) dhe në vijim, ato nuk janë deklaruar prej saj në asnjë prej deklaratave periodike vjetore të pasurisë, përveç deklaratës së pasurisë (*vetting*).**

**11.4 Mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni lidhur me kontrollin e pasurisë së paluajtshme në pronësi të fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit, të llojit “ndërtesë + truall”, të dyja me të njëjtën sipërfaqe 106,7 m<sup>2</sup>, nr. pasurie {\*\*\*}, ZK nr. {\*\*\*}, adresë “{\*\*\*}”, Durrës, origjina e pasurisë së paluajtshme – kontratë dhurimi me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.05.2017, pranë noterit publik Sh. C., me palë prindërit e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e dhuruesit dhe fëmijët e mitur të subjektit në cilësinë e pranuesit të dhurimit<sup>5</sup>, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se nuk është kryer hetim i plotë në drejtim të (i) marrëdhënies së huamarrjes mes babait të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit dhe babait të ndjerë të subjektit të rivlerësimit, për financimin prej këtij të fundit të blerjes së kësaj pasurie të paluajtshme; (ii) verifikimeve për kryerjen e pagesës pranë noterit për llogari të transaksionit financiar të shitjes së pasurisë së paluajtshme; (iii) verifikimit të burimit për krijimin nga prindërit e subjektit të rivlerësimit të pasurisë së dhuruar dy fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit.**

**11.5 Mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me blerjen dhe, në vijim, shitjen e pasurisë së luajtshme, të llojit automjet “Land Rover, Discovery”, vit prodhimi 2005, në bashkëpronësi me të atin, në raportet respektive 40% me 60%, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se nuk është hetuar në mënyrë të plotë nga Komisioni lidhur me (i) dokumentacionin e paraqitur nga subjekti për të provuar pagesën e çmimit të blerjes së automjetit, sa i takon vlefshmërisë dhe**

<sup>5</sup> Përfaqësuar nga prindërit e tyre: subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesja e tij.

provueshmërisë së këtyre akteve; (ii) aftësisë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar vlerën e automjetit sipas pjesës së tij takuese prej 60%; si dhe (iii) mospërputhjeve të konstatuara mes akteve të administruara gjatë hetimit për pagesat e kryera (15000 euro nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe 6000 euro nga babai i tij) dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me raportet e bashkëpronësisë.

**11.6 Verifikimi i saktësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë (vetting) lidhur me përdorimin nga subjekti i rivlerësimit të automjetit “Land Rover Discovery”, vit prodhimi 2012, në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me targë {\*\*\*}, si dhe mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni në lidhje me verifikimin e raportit ligjor që ka ekzistuar mes shoqërisë pronare e automjetit dhe subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 49/4 të ligjit nr.84/2016.**

**11.7 Mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni lidhur me kontrollin e pasurive të luajtshme të llojit (i) automjet “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe (ii) automjet “Opel Corsa”, vit prodhimi 1996, në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, për të cilat Komisioneri Publik pretendoi se hetimi i Komisionit ka qenë i paplotë në drejtim të vërtetësisë së deklarimeve mbi pronësinë e këtyre dy automjeteve nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses së tij, znj. S.T., si dhe në drejtim të administrimit të dokumentacionit justifikues ligjor (kontratave të shitjes së këtyre dy sendeve të luajtshme), me qëllim vlerësimin si të ligjshme të të ardhurave në vlerën totale prej 7.000 eurosh, të pretenduara se janë fituar nga shitja e tyre.**

**11.8 Mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni lidhur me kontrollin e pasurisë së luajtshme të llojit automjet “Hyundai”, vit prodhimi 2008, në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se nuk është verifikuar ligjshmëria e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.**

**11.9 Verifikimi i saktësisë së deklaramit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të justifikuar kursimet e deklaruara në formën e likuiditetit “cash” jashtë sistemit bankar, për të cilat Komisioneri Publik pretendon se nuk është hetuar nga Komisioni diferenca e pambuluar e kursimeve cash jashtë sistemit bankar për vitet 2005, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2015, e cila arrin në total vlerën prej 4.466.990 lekësh, si dhe diferenca e kursimeve cash të deklaruara ndër vite me shumat e depozituara në bankat “Raiffeisen” dhe “Credins” në datën 19.04.2016, në total 4.264.650 lekë, e cila rezulton të mos jetë deklaruar në deklaratën vetting.**

**11.10 Mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni në drejtim të disa çështjeve të tjera të konstatuara nga Komisioneri Publik lidhur me (i) informacionet e marra nga Operatori i Energjisë Elektrike, lidhur me kontratat pranë OShEE-së, nga të cilat për instancën Vlorë kanë rezultuar 2 abonentë, me gjeneralitetet H.I. dhe 1 abonent me gjeneralitete B.I. dhe (ii) mungesën e përgjigjes së Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me kërkesën e Komisionit për përcjelljen e informacionit në**

*lidhje me rekordet kriminale të 12 shtetasve, pronarë<sup>6</sup> të mjeteve motorike të përdorura ndër vite nga subjekti i rivlerësimi, të identifikuar këta në raport me targat<sup>7</sup> e automjeteve që kanë rezultuar nga hetimet e Komisionit se janë përdorur nga subjekti i rivlerësimit.*

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### *A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

##### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### *b) Legjitimimi i ankuesit*

13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>8</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### *c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

14. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 22, datë 07.06.2018, për subjektin e rivlerësimit Edmond Islamaj, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve, me përjashtim të seancës gjatë së cilës u shpall vendimi, në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ishte i pranishëm.
15. Lidhur me kërkesën e Komisionerit Publik për kryerjen e hetimit të kriterit të kontrollit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi ankimin e Komisionerit Publik në tërësi dhe pretendoi se vendimi i Komisionit objekt ankimi, është marrë në përfundim të një hetimi të thelluar administrativ, në kuadër të të cilit janë kërkuar dhe administruar të dhëna të nevojshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur konkluzionet e Komisionit. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kërkoi mospranimin e ankimit të

<sup>6</sup> Sipas identifikimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.02.2018.

<sup>7</sup> Sipas kërkesës së Komisionit drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.01.2018.

<sup>8</sup> Referuar akteve të administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 22, datë 07.06.2018, për rivlerësimin e subjektit E. Islamaj, i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik më datë 26.06.2018, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., të së njëjtës datë, ndërsa ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.07.2018, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.07.2018, që rezulton të jetë dita e 15 e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 22, datë 07.06.2018, dhe lënien e tij në fuqi, si një vendim i drejtë, i mbështetur në fakte, prova dhe i bazuar në ligj dhe në Kushtetutë.

16. Trupi gjykues, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve lidhur me ankimin, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të hetojë disa fakte juridike lidhur me:
  - (i) pasurinë e paluajtshme të llojit “kullotë”, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Kavajë;
  - (ii) tri pasuritë e paluajtshme të llojit, “apartament”, “njësi tregtare” dhe “garazh”, në pronësi të personit të lidhur (bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, znj. S.T.), me adresë: rruga “{\*\*\*}”, lagjja {\*\*\*}, Durrës;
  - (iii) verifikimin e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur, babait të subjektit të rivlerësimit, të ndjerit B. I., për periudhën që ai ka ushtruar aktivitet privat;
  - (iv) pretendimin e subjektit të rivlerësimit për depozitimin pranë ILDKPKI-së të dy kontratave të shitjes për automjetet e deklaruar prej tij dhe bashkëjetueses së tij, përkatësisht atë të tipit “Mercedes Benz” dhe “Opel Corsa”;
  - (v) të dhënat për hyrje-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për periudhën 1 janar 2004 – 31 dhjetor 2007.
17. Trupi gjykues, pasi mori në cilësinë e provave shkresore aktet e përcjella nga institucionet kompetente shtetërore, lidhur me hetimet e zhvilluara si më sipër, si dhe aktet shkresore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me kundërshtimet e tij ndaj ankimit dhe ato në seancat në vijim, ia nënshtroi debatit gjyqësor lidhur me vlerën provuese të tyre.
18. Bazuar në këto prova të reja, të marra gjatë gjykimit në Kolegj, si dhe në funksion të shqyrtimit të shkakut të ankimit mbi verifikimin e saktësisë së deklaramit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të justifikuar kursimet e deklaruar në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, trupi gjykues vendosi të kryejë nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor analizën mbi situatën ekonomiko-financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën e rivlerësimit 2004-2016. Analiza ekonomiko-financiare iu paraqit subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, duke iu dhënë atyre mundësinë ta debatnin atë në seancë gjyqësore publike. Subjekti i rivlerësimit, në funksion të kësaj analize financiare, kërkoi marrjen e disa provave të tjera shkresore, të cilat pasi u pranuan nga trupi gjykues, u debatuan prej palëve.

*B. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

19. *Lidhur me shkakun e ankimit për mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni për kontrollin e pasurisë së paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, të llojit “kullotë”, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup>, nr. pasurie {\*\*\*}, ZK nr. {\*\*\*}, me vendndodhje në {\*\*\*}/Kavajë, trupi gjykues konstaton si më poshtë:*

**19.1** Komisioni, në vlerësimin dhe kontrollin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, rezultoi se e ka përqendruar hetimin e tij në verifikimin e të dhënave të pronës sipas kartelës së pasurisë së përcjellë nga ZVRPP Kavajë, certifikatës së pronës dhe kontratës së shitblerjes. Komisioni është shprehur se ka kryer edhe analizën financiare, me qëllim verifikimin e mundësive financiare të subjektit për të blerë pronën objekt hetimi, sipas çmimit të deklaruar të saj prej 137 lekësh/m<sup>2</sup>. Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij se nga hetimi administrativ konstatohet që deklarimi i



subjektit përputhet me të dhënat e administruara dhe se subjekti ka pasur mundësi financiare për ta blerë këtë pasuri të paluajtshme, sipas çmimit në kontratën e shitblerjes.

**19.2** Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit me pretendimin se hetimi i kryer nga ky i fundit, në lidhje me kontrollin e krijimit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, është i paplotë në drejtim të verifikimit të çmimit të ulët të blerjes së kësaj pasurie të paluajtshme, si dhe ekzistencës së transaksioneve të njëpasnjëshme dhe brenda një periudhe shumë të shkurtër, të blerjes dhe shitjes në vijim, nga pronari fillestar te subjekti i rivlerësimit, fakte këto të cilat, sipas Komisionerit Publik, “ngrenë dyshime për një sistem shit-blerjesh kaskadë”, që shërben për fshehjen e origjinës së vërtetë të pasurisë, çmimit real të shitjes dhe burimit të të ardhurave për blerjen e saj. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik kërkoi hetimin nga Kolegji në drejtim të: (i) transferimit të pronësisë nga shteti te privati, deri në momentin kur është kaluar titulli i pronësisë te subjekti i rivlerësimit; (ii) verifikimin e çmimit minimal dhe maksimal të shitblerjes për pronat kufitare të pasurisë objekt gjykimi në parcelën nr. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, bazuar në titujt e regjistruar në regjistrat hipotekorë.

**19.3** Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik për hetim të paplotë në drejtim të kontrollit të kësaj pasurie të paluajtshme pasi, sipas tij, hetimi i kryer nga Komisioni është i plotë dhe i gjithanshëm dhe se nga ky hetim nuk ka rezultuar asnjë dyshim në lidhje me kryerjen e veprimeve juridike për shitblerjen e kësaj pasurie të paluajtshme. Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik lidhur me çmimin e ulët të blerjes së pasurisë objekt gjykimi, subjekti pretendoi se ky çmim është çmimi real, i përcaktuar nga palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar, në kuadër të lirisë kontraktore dhe pasqyron gjendjen faktike të pronës, si pasuri e llojit “kullotë” dhe e pashfrytëzueshme, duke qenë se është tokë argjilore. Subjekti shpjegoi se çmimi i blerjes prej tij të pasurisë në fjalë është në të njëjtën masë që shitësi e ka përfituar atë dhe se diferenca me vetëm 10 lekë për metër katror nga çmimi i referencës së përcaktuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.07.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, është e papërfillshme.

**19.4** Subjekti kundërshtoi edhe pretendimin e Komisionerit Publik mbi afatin shumë të shkurtër midis dy transaksioneve të njëpasnjëshme të tjetërsimit të kësaj pasurie si të pabazuar dhe shpjegoi se ky fakt lidhet me regjistrimin e ndarjes së pasurisë së shitësit (z. A. H.) për qëllim të tjetërsimit të një pjese të saj, nëpërmjet shitjes, te subjekti i rivlerësimit dhe jo të faktit që kjo pasuri është regjistruar për herë të parë në emër të shitësit, z. A. H., në datën 04.02.2015. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit paraqiti këto akte:

- a) certifikatën për vërtetim pronësie në emër të z. L. A. për pasurinë e paluajtshme të llojit “kullotë”, me sipërfaqe 9293,5 m<sup>2</sup>, me nr. {\*\*\*}, ZK. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, vendndodhje {\*\*\*}, Kavajë, me nr. serie {\*\*\*}, nr. kërkesë {\*\*\*} dhe datë lëshimi 26.03.2010;
- b) kontratën noteriale të shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.07.2010 para noterit publik S. T. Gj.; si dhe
- c) kërkesën nr. {\*\*\*}, datë 27.01.2015, të z. A. H. për regjistrimin e bashkimit, ndarjes apo pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Kavajë.

**19.5** Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues çmoi të nevojshme kryerjen e hetimeve dhe, për rrjedhojë, kërkoi<sup>9</sup> nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kavajë (në vijim ZVRPP Kavajë) përcjelljen e informacionit dhe

<sup>9</sup> Me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 20.11.2018, drejtuar ZVRPP Kavajë.

dokumentacionit përkatës lidhur me historikun e kalimeve të pronësisë së pasurisë së paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, të llojit “kullotë”, me nr. pasurie {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, zona kadastrale nr. {\*\*\*} në {\*\*\*}/Kavajë, që nga momenti fillestar, kur kjo pasuri ka qenë në pronësi të shtetit dhe ka kaluar në pronësi të privatit e deri në kalimin e fundit te subjekti i rivlerësimit Edmond Islamaj, sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. {\*\*\*}, datë 04.02.2015, duke përfshirë këtu të gjitha kalimet e pronësisë midis subjekteve private.

**19.6** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga ZVRPP Kavajë dhe akteve të përcjella nga vetë subjekti i rivlerësimit, në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga palët lidhur me këtë pasuri të paluajtshme, trupi gjykues konstaton se pasuria e paluajtshme objekt shqyrtimi, e llojit “kullotë” me nr. pasurie {\*\*\*}, ZK. {\*\*\*}, {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, rrjedh nga pasuria e llojit “kullotë” me nr. pasurie {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, në pronësi të shtetit, e cila ka kaluar në pronësi të privatit në vitin 2008, sipas regjistrimit të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 19.08.2008, në emër të bashkëpronarëve G. Në vijim, pas disa transaksioneve të shitblerjes dhe ndarjes së pasurisë, ka kaluar nga shitësi A. H. te subjekti i rivlerësimit, sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.03.2015 para noterit J.Zh.

**19.7** Shitësi A.H. rezulton të ketë fituar pronësinë mbi pasurinë objekt të kontratës së sipërcituar, më datë 12.07.2010, sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., para noterit publik S.T.Gj. Në këtë kontratë, z. L.A. rezulton të jetë shitës i një parcele me sipërfaqe 9293,5 m<sup>2</sup>, e identifikuar si pasuri e llojit “kullotë”, me nr. pasurie {\*\*\*}, ZK. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, nga ndarja e së cilës, në datën 14.02.2015, ka prejardhjen edhe parcela me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, {\*\*\*}, e cila i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, si më sipër shpjeguar. Të gjitha shitblerjet e kësaj pasurie të paluajtshme, nga marsi i vitit 2010 deri në mars të vitit 2015, rezulton të kenë pasur të njëjtin çmim për metër katror, atë prej 137 lekësh, të identifikuar dhe në kontratën objekt shqyrtimi gjyqësor.

**19.8** Në analizë të fakteve të sipërcituara, në drejtim të dyshimit të ngritur nga Komisioneri Publik, trupi gjykues çmon se nga hetimi i kryer prej Komisionit dhe Kolegjit nuk rezultoi asnjë fakt apo e dhënë, e cila të mund të krijonte dyshim të arsyeshëm për parregullsi/paligjshmëri në drejtim të kalimit të pronësisë së parcelës me nr. pasurie {\*\*\*} nga shteti te privati. Gjithashtu nuk rezultoi përfshirje e organeve gjyqësore në zgjidhjen e ndonjë mosmarrëveshjeje lidhur me pasurinë e paluajtshme në fjalë, që do të mund të krijonte dyshim për kontribut të subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim. Rezultatet e hetimit nuk prodhuan të dhëna në drejtim të ekzistencës së një sistemi shitblerjeje pasurie, që synon shkëputjen e lidhjes mes shitësit dhe blerësit real nëpërmjet përfshirjes së një pale të tretë, me qëllim fshehjen e origjinës së vërtetë të pasurisë. Këto transaksione, të cilat për nga natyra kryhen në mënyrë të njëpasnjëshme dhe brenda periudhave të afërta kohore me njëra-tjetrën, në rastin në fjalë nuk u provuan sepse ekziston një shkëputje me rreth 5 vjet nga blerja prej z. A.H. e pasurisë objekt shqyrtimi nga z. L.A., te shitja e një pjese të saj subjektit të rivlerësimit.

**19.9** Diferenca me vetëm 10 lekë për metër katror mes çmimit të kontratës së shitblerjes dhe çmimit të përcaktuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.07.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, ndërkohë që detyrimet tatimore për

kalimin e pronësisë së paluajtshme janë paguar sipas çmimit të referencës, në mungesë të të dhënave/indicieve në fashikullin gjyqësor dhe në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit për pyetjen e trupit gjykues në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, u vlerësua nga trupi gjykues si e dhënë e pamjaftueshme për të angazhuar Kolegjin në hetime të mëtejshme në drejtim të çmimit të shitblerjes, përcaktimi i të cilit është rezultat i përputhjes së vullnetit të lirë dhe të pavesuar të palëve, në kuadër të parimit të lirisë kontraktore sipas legjislacionit civil në fuqi.

**19.10** Në konkluzion të sa më sipër, lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se nga hetimi nuk rezultuan prova të cilat cenojnë vendimmarrjen e Komisionit lidhur me kontrollin e kryer mbi këtë pasuri të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit.

- 20.** *Në lidhje me shkakun e ankimit për hetim të paplotë të tri pasurive të paluajtshme në pronësi të personit të lidhur (bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, znj. S.T.), me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, lagjja {\*\*\*}, Durrës, trupi gjykues konstaton sa më poshtë:*

**20.1** Komisioni në vlerësimin dhe kontrollin e këtyre tri pasurive të paluajtshme në pronësi të personit të lidhur (bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit) shprehet në vendim: *Lidhur me çmimin e shitblerjes, duke qenë se kemi të bëjmë me një kontratë shitblerjeje ndërmjet babait dhe vajzës, nisur edhe nga fakti se në këtë periudhë të lidhjes së kësaj kontrate nuk ka një çmim të detyrueshëm reference për metër katror, nuk lindin dyshime të arsyeshme për shkelje ligjore.*

*Nga ana tjetër, analiza financiare e bashkëjetueses së subjektit vërteton mundësitë e saj për blerjen e kësaj pasurie në shumën 1.000.000 lekë, duke konkluduar se nga analiza e dokumentacionit rezulton se subjekti ka qenë i saktë dhe i vërtetë në deklarin e tij.*

**20.2** Komisioneri Publik pretendon në ankimin e tij se Komisioni nuk ka hetuar në mënyrë të plotë krijimin e këtyre tri pasurive të paluajtshme prej bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, sa i takon:

(i) ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara nga personi i lidhur, si të krijuara në periudhën 1999-2001 dhe të përdorura si burim për krijimin prej saj të këtyre tri pasurive të paluajtshme;

(ii) analizës financiare për efekt të vlerësimit të mundësive financiare të personit të lidhur për mbulimin e vlerës së blerjes së këtyre pasurive në vitin 2001;

(iii) mospërputhjeve mes dokumenteve hipotekore të dorëzuara nga subjekti në cilësinë e dokumenteve provuese bashkëlidhur deklaratës *vetting* dhe dokumentacionit përkatës që është përcjellë nga ZVRPP Durrës, sipas kërkesës së Komisionit në kuadër të hetimit, lidhur me datën dhe numrat hipotekorë të regjistrimit të veprimeve juridike që kanë kaluar të drejtën e pronësisë mbi këto pasuri në emër të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit;

(iv) ekzistencës së kontratës për furnizimin me energji elektrike të një prej pasurive në fjalë (apartamentit të banimit), e cila rezulton e lidhur në emër të subjektit të rivlerësimit dhe jo të personit të lidhur, në datën 05.05.2001, para lidhjes së kontratës së shitblerjes midis personit të lidhur dhe babait të saj (në cilësinë e shitësit).

**20.3** Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit Edmond Islamaj u shpreh se ndryshe nga sa parashtron Komisioneri Publik, hetimi ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm dhe se pretendimet e ngritura nga Komisioneri nuk qëndrojnë. Më konkretisht:

(i) Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur, si të krijuara në periudhën 1999-2001 nga puna pranë qendrës “{\*\*\*}” dhe të përdorura si burim për krijimin prej saj të këtyre tri pasurive të paluajtshme, subjekti pretendoi se këto janë të ardhura të ligjshme, referuar nenit 49/1 të Kushtetutës, duke qenë se gjatë hetimit janë administruar prova që vërtetojnë ekzistencën e marrëdhënieve juridike të punës së bashkëjetueses, marrëdhënie këto të cilat kanë qenë të ligjshme dhe se pagesa ose jo e detyrimeve tatimore nuk mund të vëre në diskutim ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Subjekti gjithashtu pretendoi se si burim për krijimin prej bashkëjetueses së tij të këtyre tri pasurive të paluajtshme ka shërbyer, përveç të ardhurave të deklaruara nga puna pranë qendrës “{\*\*\*}”, edhe kontributi i saj në aktivitetin tregtar të familjes, si dhe puna pranë një OJF-je ndërkombëtare “{\*\*\*}” për periudhën qershor 1999 - shtator 1999.

(ii) Sa u takon mospërputhjeve në dokumentacionin hipotekor të administruar gjatë hetimit në Komision, subjekti arsyetoi se këto mospërputhje vijnë si pasojë e sistemeve të ndryshme ligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë prej organit kompetent dhe, për rrjedhojë, pretendoi se këto mospërputhje nuk janë tregues i regjistrimit të vonuar të titujve të pronësisë, lidhur me pasuritë në fjalë. Ai pretendoi se bashkëjetuesja e tij nuk ka qenë subjekt penalitetesh për vonesa në regjistrim të titujve të pronësisë së fituar mbi këto pasuri të paluajtshme, sipas legjislacionit të kohës.

(iii) Sa i takon faktit të lidhjes së kontratës së furnizimit me energji elektrike të apartamentit në emër të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit pranoi se kjo kontratë është lidhur në emër të tij, por njëkohësisht pretendoi se ky veprim nuk është kryer personalisht prej tij, por prej bashkëjetueses së tij apo familjarëve të saj, në shenjë besimi dhe miratimi të marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me bashkëjetuesen e tij të ardhshme. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ky fakt nuk mund të vërtetohet që mes tij dhe personit të lidhur, në momentin e lidhjes së kontratës për furnizimin me energji elektrike, të jetë lidhur bashkëjetesë ligjore, sikundër dhe se subjekti i rivlerësimit nëpërmjet këtij veprimi juridik të ketë fituar të drejta reale mbi pasurinë e paluajtshme objekt i kontratës së furnizimit.

**20.4** Në shqyrtim të pretendimit të Komisionerit Publik se hetimi në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit për periudhën tetor 1999 – korrik 2000 ka qenë i paplotë, trupi gjykues konstaton se:

**20.5** Në lidhje me këto të ardhura, të deklaruara në deklaratën e pasurisë (*vetting*) si “të ardhura nga paga për periudhën tetor 1999 – korrik 2000, pranë qendrës “{\*\*\*}”, me pagë mujore 500 dollarë amerikanë, Komisioni nuk rezulton të ketë kërkuar informacion apo të ketë verifikuar deklaratimet e bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit pranë organeve tatimore. Pavarësisht kësaj, konstatohet se lidhur me këtë çështje është administruar nga ana e ILDKPIKI-së<sup>10</sup> në vijim të kërkesës<sup>11</sup> për përcjellje të dhënash drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 19.07.2017, me anë të së cilës informohet ILDKPKI-ja se në lidhje me shtetasen S.A.T., me ID {\*\*\*}, nuk rezulton që kjo e fundit të jetë regjistruar si punëmarrëse apo e punësuar pranë ndonjë subjekti tatimpagues joshjetëror në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tiranë, deri në datën 31.01.2017.

**20.6** Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se, pavarësisht faktit që Komisioni nuk ka kryer hetime të posaçme lidhur me verifikimin pranë autoriteteve tatimore të deklarimeve të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, mbi të ardhurat e deklaruara prej saj si të realizuara në periudhën tetor 1999 – korrik 2000, edhe nëse do të ishte kryer ky hetim, rezultatet e tij do të

<sup>10</sup> Për efekt të verifikimit të të ardhurave të deklaruara të përfituara nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit, sipas vërtetimit të lëshuar më datë 30.01.2017 nga qendra “{\*\*\*}”, nënshkruar nga administratorja e kësaj qendre, znj. H.Z.

<sup>11</sup> Me nr. {\*\*\*} prot., datë 19.06.2017.

konsistonin në administrimin e dokumentacionit me të njëjtën përmbajtje me atë të administruar nga ILDKPKI-ja. Për rrjedhojë, edhe investimi i Kolegjit në kryerjen e hetimeve në drejtim të verifikimit pranë autoriteteve tatimore dhe marrja e provës përkatëse nuk u çmuan të nevojshme nga trupi gjykues, i cili duke mbajtur në konsideratë edhe deklarinimin e subjektit gjatë gjykimit për pamundësi të sjelljes së provave në këtë drejtim, vlerësoi se çështja mund të zgjidhet me dokumentacionin e administruar në fashikullin gjyqësor.

**20.7** Duke marrë shkas nga analiza e mësipërme, në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të deklaruara si të realizuara nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës tetor 1999 – korrik 2000, trupi gjykues konstaton se i vetmi dokumentacion që subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (*vetting*) në përputhje me detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të të provuarit të këtij fakti, është vërtetimi i datës 30.01.2017, i lëshuar nga administratorja e qendrës “{\*\*\*}”, znj. H.Z. Gjatë shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik në Kolegji, subjekti i rivlerësimit së bashku me kundërshtimet e tij ndaj këtij shkakut ankimi paraqiti një “Letër rekomandimi”, të nënshkruar nga znj. H.K., në cilësinë e administratores së qendrës “{\*\*\*}”, që mban datën 27.02.2001.

**20.8.** Nga shqyrtimi i akteve të mësipërme, konstatohet se, referuar vërtetimit të datës 30.01.2017, lëshuesi i tij vërteton se znj. S.T. ka qenë e kontraktuar si përkthyes dhe hedhëse të dhënash pranë qendrës “{\*\*\*}”, çka nënkupton ekzistencën e një marrëdhënieje kontraktuale për ofrimin e shërbimeve profesionale mes palëve dhe jo të një marrëdhënieje punësimi, sikundër ka deklaruar personi i lidhur në deklaratën e pasurisë (*vetting*).

**20.9.** Në këto kushte trupi gjykues, pasi konstaton se:

(i) statusi ligjor i subjektit (qendra “{\*\*\*}”) që ka lëshuar vërtetimin e datës 31.01.2017, që nga koha e pretenduar (tetor 1999) që znj. T. ka qenë e kontraktuar si përkthyes dhe hedhëse të dhënash, si dhe në datën e lëshimit të vërtetimit, sikundër dhe cilësia e personit nënshkruar të vërtetimit dhe “Letrës së rekomandimit” mbetën të paprovuara për trupin gjykues. Subjekti i rivlerësimit, në kuptim të detyrimit të tij ligjor të parashikuar nga neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk arriti të provojë me asnjë dokumentacion ligjor ekzistencën e kësaj qendre dhe regjistrimin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, që nga data e pretenduar se bashkëjetuesja e tij ka qenë e punësuar/kontraktuar pranë kësaj qendre e deri më sot. Subjekti i rivlerësimit nuk i paraqiti trupit gjykues asnjë përpjekje për të siguruar dokumentacion pranë organeve kompetente në këtë drejtim;

(ii) deklarimi në deklaratën e pasurisë (*vetting*) i personit të lidhur për realizimin e të ardhurave me burim marrëdhënien e punësimit bie ndesh me vërtetimin e datës 30.01.2017, të administratores së qendrës “{\*\*\*}”, e cila deklaroi ekzistencën e një marrëdhënieje kontraktuale shërbimesh mes znj. T. dhe qendrës që ajo administron;

(iii) marrëdhënia kontraktuale e deklaruar në vërtetimin e datës 30.1.2017 të administratores së qendrës “{\*\*\*}” nuk u arrit të provohet me dokumentacion ligjor, pasi subjekti nuk solli asnjë provë në drejtim të këtij fakti;

(iv) në raport me të ardhurat e deklaruara në vlerën prej 5000 dollarësh amerikanë, nuk ka asnjë të dhënë nga organet shtetërore përkatëse lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore që burojnë nga një marrëdhënie e rregullt punësimi apo çdo marrëdhënie tjetër kontraktuale apo aktiviteti të posaçëm profesional që do të kishte sjellë të ardhura për personin e lidhur, fakt ky që do të shërbente si provë e ekzistencës së një burimi të tillë të ligjshëm të ardhurash;

– arrin në përfundimin se lidhur me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë (*vetting*) si “të ardhura nga paga për periudhën tetor 1999 – korrik 2000, pranë qendrës

“{\*\*\*}”, me pagë mujore 500 dollarë amerikanë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, as në formën e një marrëdhënieje të rregullt punësimi, as edhe në formën e një marrëdhënieje kontraktuale shërbimi. Për rrjedhojë, vlera e deklaruar si e realizuar nga personi i lidhur gjatë kësaj periudhe, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, nuk u arrit të provohet se është një e ardhur e realizuar nga një burim i ligjshëm dhe për të cilën janë paguar detyrimet përkatëse tatimore.

**20.10** Në shqyrtim të pretendimit të Komisionerit Publik, lidhur me mungesën e analizës financiare në drejtim të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të mbuluar vlerën e blerjes së këtyre pasurive prej 1.000.000 lekësh nga personi i lidhur në vitin 2001, trupi gjyqësor, pasi dëgjoi pretendimet e Komisionerit Publik, kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi aktet e administruara në fashikullin gjyqësor dhe provat e marra gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, në dritën edhe të përfundimeve të arritura nga analiza e mësipërme mbi ligjshmërinë e të ardhurave të personit të lidhur, konstaton si më poshtë:

(i) Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) personi i lidhur ka deklaruar pronësinë e fituar sipas kontratës së shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.11.2001, pranë noterit publik N.C. mbi tri pasuritë e paluajtshme objekt gjykimi, me vlerë totale prej 1.000.000 lekësh, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tyre.

(ii) Në deklaratën e Interesave Privatë Periodikë/Vjetorë të vitit 2005, të administruar gjatë hetimit të kryer nga Kolegji, me anë të dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.11.2018, personi i lidhur ka deklaruar në rubrikën e deklaratimit të interesave privatë, pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, tri pasuritë e paluajtshme objekt gjykimi, me vlerë totale prej 1.000.000 lekësh, me origjinë kontratën e shitjes nga i ati, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tyre.

(iii) Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, gjatë seancës së datës 12.11.2018, në kundërshtimet e tij ndaj ankimit të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *sa i përket burimit të krijimit të të ardhurave për blerjen e këtyre tri pasurive nga bashkëjetuesja ime, S.T., në hetimin administrativ janë grumbulluar prova të mjaftueshme që vërtetojnë pasjen e burimeve të ligjshme financiare që justifikojnë fitimin e pronësisë mbi këto pasuri.*

*Konkretisht, bashkëjetuesja ime ka siguruar të ardhura nga puna pranë OJF-së “{\*\*\*}” për periudhën tetor 1999 deri në korrik 2000. Para kësaj periudhe, ka punuar pranë një tjetër OJF-je ndërkombëtare, “{\*\*\*}”, i cili u vendos në vendin tonë për shkak të konfliktit në Kosovë. Nga drejtuesja e këtij grupi, bashkëjetuesja ka vetëm karakteristikën e punës dhe jo të ardhurat, sepse nuk ka pasur më mundësi ku t’i gjejë ato. Po kështu, bashkëjetuesja ka qenë e regjistruar si person fizik, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.02.2001, ku ka kryer aktivitetin e saj të përkthimit dhe tregtimit të mjeteve kancelarike, pikërisht pranë ambienteve tregtare të familjes së saj.*

*Të dyja këto punët e fundit që rendita, ne nuk mund t’i provojmë me dokumente provuese të përkthyer në shifra, se sa kanë qenë të ardhurat e realizuara prej saj, pavarësisht hapësirës ligjore dhe parashikimit konkret shumë të rëndësishëm që ka bërë ligjvënësi në Kushtetutë në nenin D të Aneksit të saj.*

(iv) Gjatë hetimit administrativ, në Komision është administruar informacion<sup>12</sup> nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas të cilit personi i lidhur, znj. S.R.<sup>13</sup>.T., e datëlindjes {\*\*\*}, figuron e

<sup>12</sup> Me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 29.01.2018.

<sup>13</sup> Në dokumentacionin e fashikullit gjyqësor, i ati i bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit rezulton me emrat A. dhe R.

regjistruar si person fizik, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.02.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilin nuk gjendet NUIS (NIPT), pasi ky nuk është përcjellë nga organet tatimore.

**20.11** Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në kuadër të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, kanë detyrimin jo vetëm të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tyre, por edhe të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve të tyre për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në këtë kuptim, referuar dokumentacionit të fashikullit gjyqësor, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë vërtetësinë e deklarimeve të tij gjatë seancës gjyqësore publike se, si burime për krijimin e tri pasurive të paluajtshme në emër të bashkëjetueses së tij, përveç punës pranë qendrës “{\*\*\*}”, kanë shërbyer edhe të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i saj tregtar pranë ambienteve tregtare të familjes, pretendim ky i cili rezultoi i deklaruar për herë të parë gjatë gjykimit në Kolegj. Për më tepër, të ardhurat nga ky burim nuk janë deklaruar as në deklaratën e pasurisë (*vetting*) dhe, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbeti i paprovuar, pasi as regjistrimi pranë organeve tatimore për ushtrimin e aktivitetit privat në formën e personit fizik, sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 13.02.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nuk u arrit të provohet prej tij. Madje, subjekti i rivlerësimit nuk tregoi asnjë përpjekje në drejtim të sa më sipër, në mënyrë që të provonte pamundësinë e tij për të siguruar këto të dhëna.

**20.12** Trupi gjykues vlerëson se në nivel pretendimi të paprovuar mbeti gjithashtu edhe burimi i të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga puna e personit të lidhur pranë OJF-së ndërkombëtare, “{\*\*\*}”, gjatë periudhës qershor 1999 - shtator 1999, në vlerën e 400 dollarëve amerikanë. Subjekti i rivlerësimit pretendoi pamundësi për të provuar me dokumentacion këtë të ardhur, edhe pse nuk tregoi asnjë përpjekje në këtë drejtim. Megjithatë, edhe sikur për një moment trupi gjykues të pranonte se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacionin që provon ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përsëri vlera e deklaruar e tyre, prej 400 dollarësh amerikanë në muaj, për një periudhë maksimalisht 4-mujore, është e papërfillshme në drejtim të analizës mbi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e tri pasurive të paluajtshme.

**20.13** Në përfundim të sa më sipër, në dritën edhe të përfundimeve të arritura nga analiza e kryer mbi ligjshmërinë e të ardhurave të personit të lidhur, të deklaruara si të realizuara nga puna pranë qendrës “{\*\*\*}”, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, për sa kohë nuk u arrit të provohet burimi i krijimit të të ardhurave të deklaruara gjatë shqyrtimit gjyqësor se kanë shërbyer si burim për krijimin e tri pasurive të paluajtshme, të fituara nëpërmjet kontratës së shitblerjes nga bashkëjetuesja e tij, dhe për sa kohë sa deklaruar më sipër përbën të vetmet burime të përdorura për krijimin e këtyre tri pasurive, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëjetuesja e tij) kanë kryer deklaram të paplotë të këtyre tri pasurive në deklaratën e pasurisë (*vetting*) dhe atë periodike vjetore të vitit 2005, sa i takon burimit të krijimit, deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë (*vetting*) të të ardhurave nga puna pranë qendrës “{\*\*\*}” dhe ato pranë qendrës humanitare “{\*\*\*}”, si dhe ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar të tria këto pasuri të paluajtshme, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**20.14** Sa u takon pretendimeve të Komisionerit Publik për hetim të pamjaftueshëm në drejtim të ekzistencës së mospërputhjeve të evidentuara, të pranuar edhe nga subjekti i rivlerësimit, midis dokumenteve hipotekore të dorëzuara nga subjekti në cilësinë e dokumenteve provuese bashkëlidhur deklaratës *vetting* dhe dokumentacionit përkatës që është përcjellë nga ZVRPP Durrës, sipas kërkesës së Komisionit në kuadër të hetimit administrativ, lidhur me datën dhe

numrat hipotekorë të regjistrimit të veprimeve juridike që kanë kaluar të drejtën e pronësisë së pasurive objekt gjykimi në emër të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi këto mospërputhje dhe efektet e tyre në procesin e rivlerësimit, çmoi të nevojshme kryerjen e hetimeve dhe për rrjedhojë, me anë të shkresës nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2018, i kërkoi ZVRPP, Durrës:

1. informacion lidhur me kohën se kur është kryer regjistrimi i kalimit të pronësisë së tri pasurive të paluajtshme, në pronësi të znj. S.T. nga z. A.T., sipas kontratës së shitblerjes të lidhur mes palëve me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 10.11.2001, të noterit publik N.R.C.;
2. nëse i është nënshtruar zonja S.T. penaliteteve për vonesë në regjistrimin e titullit të pronësisë lidhur me tri pasuritë e paluajtshme si më sipërcituar. Nëse po, evidentimin e vlerës së kamatëvonesës së aplikuar;
3. informacion në lidhje me rivlerësimin e këtyre tri pasurive të paluajtshme, të kryer sipas urdhrit të regjistruarit të ZVRPP Durrës nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2012, si dhe kopje të njësuar të praktikës së rivlerësimit për të tria pasuritë e paluajtshme dhe vlerës së paguar në formën e tarifës së rivlerësimit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

**20.15** Pas shqyrtimit të informacionit të përcjellë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 26.04.2018, dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, trupi gjykues konstatoi se kontrata e shitblerjes së tri pasurive të paluajtshme me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 10.11.2001, në prani të noterit publik N.R.C., është aplikuar pranë kësaj zyre më datë 13.11.2001, me nr. aplikimi {\*\*\*}, brenda afatit 30-ditor dhe, për rrjedhojë, znj. T., për efekt të regjistrimit të titullit të pronësisë mbi këto tri pasuri të paluajtshme, nuk i është vendosur asnjë lloj kamatë vonese. Ndërkohë pagesa për rivlerësimin e këtyre tri pasurive të paluajtshme u konfirmua nga ZVRPP, Durrës në vlerën prej 164.042 lekësh, e paguar në vitin 2012.

**20.16** Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se nga hetimi i kryer mbi mospërputhjet e konstatuara në të dhënat lidhur me datën dhe numrat hipotekorë të regjistrimit të veprimeve juridike që kanë kaluar të drejtën e pronësisë në emër të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, nuk u evidentua të ketë shkelje në lidhje me regjistrimin e titullit të pronësisë apo vonesa në këtë drejtim. Për rrjedhojë, ekzistenca e këtyre mospërputhjeve, për sa kohë nuk është tregues i paligjshmërive në drejtim të regjistrimit të titullit të pronësisë apo fshehjes së pagesave në formën e penaliteteve për vonesa në regjistrim, nuk mund të shihet si shkak që ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit. Sa i takon pagesës prej 164.042 lekësh për rivlerësimin e këtyre tri pasurive të paluajtshme në vitin 2012, trupi gjykues çmon se kjo pagesë do të vlerësohet në drejtim të efekteve që ajo sjell në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për vitin në të cilin është kryer.

**20.17** Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik për hetim të paplotë sa i takon faktit të lidhjes së kontratës së furnizimit me energji elektrike të njëjës prej tri pasurive të paluajtshme (apartamentit) në emër të subjektit të rivlerësimit, fakt ky i pranuar edhe nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmoi të panevojshëm hetimin e mëtejshëm të këtij fakti, për sa kohë, referuar analizës së pretendimit të Komisionerit Publik lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave dhe mjaftueshmërinë e burimeve për krijimin e këtyre tri pasurive, pozicioni i subjektit të rivlerësimit në raport me vlerësimin e kriterit të kontrollit të këtyre tri pasurive është i qartë dhe hetime të mëtejshme në këtë drejtim, në kuadër edhe të ekonomisë gjyqësore, u çmuan të panevojshme.

**20.18** Në vijim të sa më sipër, sa i takon shkakut të ankimit lidhur me tri pasuritë e paluajtshme në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, referuar konkluzionit të arritur sipas paragrafit 20.13 më sipër, arrin në përfundimin se vendimi i Komisionit është i cenushtëm



sa i takon vlerësimin mbi mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit të këtyre tri pasurive të paluajtshme, si dhe në drejtim të saktësisë dhe plotësisë së deklarimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të në deklaratën e pasurisë (*vetting*) mbi burimin e krijimit dhe të ardhurat e deklaruara si të përdorura për krijimin e tyre.

21. *Lidhur me shkakun e ngritur në ankim mbi verifikimin e saktësisë së deklarimit lidhur me dy pasuritë e paluajtshme në përdorim (pa titull) të personit të lidhur (bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit), të llojit “garsonierë”, me sipërfaqe 32 m<sup>2</sup> secila, me vendndodhje te “{\*\*\*}”, Durrës, trupi gjykues konstaton:*

21.1 Komisioni në vendimin e tij, sa u takon këtyre dy pasurive çmon se nuk ka dyshime për fshehje të pasurisë apo të të ardhurave që mund të burojnë prej saj. Sipas Komisionit, subjekti ka qenë korrekt në deklarimin e së drejtës së përdorimit të këtyre dy garsonierave.

21.2 Në lidhje me vlerësimin e këtyre 2 pasurive në përdorim (pa titull) nga personi i lidhur (bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit), Komisioneri Publik shprehet se këto pasuri, që nga momenti për të cilin është pohuar se janë në përdorim të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit (viti 2010-2011) dhe në vijim, nuk janë deklaruar, konstatim ky i cili mund të kuptohet si një pretendim për shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit të detyrimit për deklarim dhe, për rrjedhojë, pretendim i nënkuptuar për zbatim të gabuar të ligjit nga ana e Komisionit.

21.3 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se për këto dy pasuri të paluajtshme<sup>14</sup>, të përegjistruara ende në regjistrat e pasurive të paluajtshme, bashkëjetuesja e tij nuk gëzon as të drejta pronësie dhe as ndonjë të drejtë tjetër reale mbi këto pasuri, pavarësisht posedimit të tyre. Për rrjedhojë, në kundërshtim me sa pretendon Komisioneri Publik, subjekti pretendoi se ai dhe bashkëjetuesja e tij nuk kanë pasur detyrim për t'i deklaruar këto pasuri në kuadër të dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.03.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049, datë 10.04.2003”).

21.4 Në shqyrtim të këtij shkakun të ankimit, trupi gjykues çmon të marrë në analizë legjislationin në fuqi që përcakton detyrimin e subjekteve për deklarim dhe objektin e këtij deklarimi, si vijon:

- Sipas nenit 4, shkronja “gj” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, të ndryshuar me ligjin nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”, objekt deklarimi, përveç pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to, janë edhe interesat privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës.
- Referuar nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), dispozitë kjo e cila ka ndryshuar me miratimin e ligjit nr. 45/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”, duke përfshirë në rrethin e familjarëve edhe bashkëjetuesen e subjektit deklarues.

21.5 Duke qenë se këto dy pasuri të paluajtshme, të cilat, referuar të dhënave të administruara në fashikullin gjyqësor, nuk rezultojnë të kenë kaluar në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të

<sup>14</sup> Origjina e këtyre dy pasurive të paluajtshme është kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 15.01.2004, e lidhur nga shoqëria “{\*\*\*}” ({\*\*\*}) dhe A.T. (i ati i bashkëjetueses), në cilësinë e pronarit të truallit që do të zhvillohej prej të cilit ky i fundit do të përfitonte 23% të ndërtimit. Si pasojë e problematikave me shoqërinë sipërmarrëse, objekti është ende i përegjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, edhe pse i përfunduar, por ndërkohë pjesa takuese e porositësit në objektin e ndërtuar i është dorëzuar zotit T., prej së cilës dy prej njësive që i takojnë, ia ka lënë në posedim së bijës, znj. S.T.

rivlerësimit dhe as u provua gjatë hetimit administrativ apo gjykimit në Kolegj që personi i lidhur të ketë fituar të drejta reale mbi këto dy pasuri të paluajtshme, sipas përcaktimeve të Kodit Civil, trupi gjykues arrin në përfundimin se këto dy pasuri mund të përfshihen në objektin e deklaramit të përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, vetëm në formën e interesit privat që burojnë nga marrëdhëniet familjare. Për rrjedhojë, referuar dispozitave të sipërcituara, personi i lidhur nuk ka pasur detyrim ligjor t'i deklarojë këto pasuri (në formën e një interesi privat që ka buruar nga një marrëdhënie familjare) deri në vitin 2014. Me miratimin e ligjit nr. 45/2014, i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2014 dhe efektivisht i ka sjellë pasojat në deklaramet periodike për këtë vit (që duhet të depozitoheshin pranë ILDKPKI-së brenda marsit të vitit 2015), ka lindur dhe detyrimi ligjor i bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit për t'i deklaruar këto dy pasuri të paluajtshme, i cili rezulton të mos jetë përmbushur.

**21.6** Megjithatë, në kushtet kur hetimi administrativ nuk prodhoi asnjë të dhënë në drejtim të përdorimit të këtyre dy pasurive nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, me qëllim realizimin e të ardhurave, trupi gjykues arrin në përfundimin se pasaktësia në deklaramet periodike pas vitit 2014, sa i takon mosdeklaramit prej personit të lidhur të këtyre dy pasurive në formën e një interesi privat, si më sipër cituar, nuk mund të vlerësohet si deklarim i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja "c" dhe, si rrjedhojë, nuk e bën të cenueshëm vendimin e Komisionit, lidhur me këto dy pasuri të paluajtshme në posedim të personit të lidhur. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të pabazuar këtë shkak ankimi.

22. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për hetim të paplotë në drejtim të kontrollit të pasurisë së paluajtshme në pronësi të fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit dhe të dhuruar nga prindërit e tij, trupi gjykues konstaton:*

**22.1** Kjo pasuri e paluajtshme është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit në cilësinë e blerësit, nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 23.10.2014, të lidhur në prani të noterit publik Sh.C. nga babai i bashkëjetueses së subjektit dhe tre personave të tjerë, të afërm të tij, në cilësinë e palës shitëse, me vlerën prej 3.000.000 lekësh. Çmimi i blerjes prej 3.000.000 lekësh, sipas rezultateve të hetimit të kryer nga Komisioni, rezulton të jetë financiar nga një marrëdhënie huamarrjeje në të njëjtën vlerë mes babait të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e huadhënësit, dhe babait të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e huamarrësit. Kjo pasuri në vijim u ka kaluar fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet kontratës së dhurimit me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.05.2017, në prani të noterit publik Sh.C., me palë prindërit e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e dhuruesit dhe fëmijët e mitur të subjektit në cilësinë e pranuesit të dhurimit<sup>15</sup>. Kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë (*vetting*), pasi dhurimi ka ndodhur pas dorëzimit të deklaratës nga subjekti i rivlerësimit.

**22.2** Komisioni lidhur me këtë pasuri, në vendimin e tij ka arsyetuar se nuk rezultoi asnjë problem lidhur me origjinën e ligjshme të kësaj pasurie, se subjekti nuk ishte në gjendje të shpjegonte këtë marrëdhënie ndërmjet të ndjerit, babait të tij, dhe z. A.T. dhe se nuk u evidentua asnjë element provues për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në këtë proces.

**22.3** Komisioneri Publik në ankimin e tij pretendon mangësi në hetimin e kryer nga Komisioni në drejtim (i) të marrëdhënies së huamarrjes mes babait të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit dhe babait të ndjerë të subjektit të rivlerësimit për financimin e blerjes prej këtij të fundit të kësaj

<sup>15</sup> Përfaqësuar nga prindërit e tyre: subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesja e tij.

pasurie të paluajtshme; (ii) të verifikimeve për kryerjen e pagesës pranë noterit për llogari të transaksionit financiar të shitjes së pasurisë së paluajtshme; si dhe (iii) të verifikimit të burimit për krijimin e pasurisë së dhuruar dy fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit.

**22.4** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik për hetim të paplotë lidhur me vlerësimin dhe kontrollin e kësaj pasurie në emër të fëmijëve të tij të mitur. Në kundërshtim me sa pretendon Komisioneri Publik, subjekti prapësoi që mes babait të tij, në cilësinë e blerësit të pasurisë objekt shqyrtimi, dhe babait të bashkëjetueses së tij, në cilësinë e shitësit të saj, të ketë ekzistuar ndonjë marrëdhënie huamarrjeje, duke qenë se çmimi i shitjes është paguar nga babai i tij i ndjerë me kursimet e tij, fillimisht me para në dorë dhe në vijim nëpërmjet transaksionit bankar me kërkesë të noterit, në kuadër të legjislacionit në fuqi për shitblerjen e pasurive të paluajtshme. Për rrjedhojë, subjekti pretendoi se transaksioni bankar objekt shqyrtimi konsiston në kthimin e parave të paguara, fillimisht me para në dorë, nga babai i subjektit te babai i bashkëjetueses dhe jo marrjes së huas prej këtij të fundit, në të njëjtën vlerë me çmimin e shitblerjes. Sipas subjektit, përshkrimi “si hua” i veprimit të kryer me transaksionin bankar objekt shqyrtimi, është rezultat i neglizhencës dhe gabimit të punonjësit të bankës dhe jo i ekzistencës së një marrëdhënieje huamarrjeje mes palëve.

**22.5** Sa i takon burimit për krijimin e kësaj pasurie nga babai i subjektit të rivlerësimit, ky i fundit pretendoi se pavarësisht faktit që në momentin e krijimit të pasurisë në fjalë prindërit e tij kanë qenë me pension pleqërie, ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme, kryesisht si rezultat i aktivitetit profesional privat të kryer nga babai i tij nga viti 1993 e në vijim. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti këto akte shkresore:

- a) leje e Këshillit Mbikëqyrës të Avokatisë nr. {\*\*\*}, datë 13.4.1993, “Për ushtrimin e profesionit të avokatit”;
- b) urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. {\*\*\*}, datë 24.08.2010, “Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit”.

**22.6** Në shqyrtimin e këtij shkaku ankimi, trupi gjykues çmoi të domosdoshme kryerjen e hetimit, me qëllim verifikimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për realizimin e të ardhurave nga babai i tij, i ndjeri B.I., nga ushtrimi i aktiviteteve profesionale private të avokatit, ekspertit kriminalist dhe noterit, për periudhën nga prilli i vitit 1993 dhe në vazhdim, nëpërmjet kërkesës drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, për përcjelljen e të gjitha të dhënave tatimore lidhur me të ardhurat e deklaruara nga ana e z. B.I., si të ardhura të krijuara gjatë ushtrimit të aktiviteteve të sipërcituara, për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore, sipas legjislacionit tatimor të kohës në të cilën ato janë krijuar.

**22.7** Pas administrimit të përgjigjes nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, trupi gjykues konstatoi se të ardhurat e deklaruara (në formën e xhiros) pranë autoriteteve tatimore kompetente për aktivitetet private të ushtruara si më sipërcituar, për vitet 2000-2005, arrinin vlerën totale prej 9486.650 lekësh, ndërsa detyrimet tatimore të paguara vlerën prej 551.106 lekësh, diferenca e të cilave rezulton të jetë 8.935.544 lekë. Pavarësisht faktit se kjo vlerë nuk përfaqëson vlerën e fitimit neto pas tatimit, pasi nuk reflekton zbritjen e shpenzimeve të kryera nga subjekti tatimpagues për nevojat e aktivitetit, duke pasur parasysh që aktiviteti i noterisë është aktivitet i natyrës së shërbimeve dhe shpenzimet për nevojat e këtij aktiviteti janë të ulëta në raport me të ardhurat e krijuara prej tij, trupi gjykues krijoi bindjen se babai i subjektit të rivlerësimit do të kishte mundësi

të krijonte një kursim, në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, të mjaftueshëm për të financuar blerjen e pasurisë së paluajtshme prej 3.000.000 lekësh, pa përfshirë këtu të ardhura të tjera të mundshme, nga burime të tjera, përfshirë dhe pensionin e pleqërisë, të cilat vlerësohet t'u kenë shërbyer prindërve të subjektit për të përballuar shpenzimet e jetesës.

**22.8** Ndodhur në këto kushte, për sa kohë trupi gjykues arriti të provojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi mundësinë e krijimit të të ardhurave nga babai i tij nga ushtrimi i aktivitetit privat dhe krijoi bindjen mbi mundësinë e këtij të fundit për të akumuluar kursim në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, të mjaftueshëm për të financuar blerjen e pasurisë së paluajtshme nga krushku i tij, në vlerën prej 3.000.000 lekësh, e çmoi të panevojshëm hetimin e mëtejshëm lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, për sa kohë edhe origjina e saj, si pasuri në pronësi të familjes së bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, e prejardhur nga trashëgimia, nuk ngrinte dyshime në drejtim të interesave të fshehur të subjektit të rivlerësimit apo ndonjë paligjshmërie tjetër në këtë drejtim, që do të mund të ngarkonte me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cenueshëm vendimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri.

- 23.** *Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për hetim të paplotë në drejtim të verifikimit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me blerjen dhe në vijim shitjen e pasurisë së luajtshme, automjet “Land Rover Discovery”, vit prodhimi 2005, në bashkëpronësi me të atin e tij, në raportin respektiv 40% me 60%, trupi gjykues konstaton si më poshtë:*

**23.1** Komisioni në vendimin e tij, lidhur me këtë pasuri, është shprehur: *Nga verifikimi i lëvizjeve bankare të subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij rezulton se kjo shumë nuk është depozituar në llogari të tyre. Subjekti konfirmon në deklarimin e tij se ka përfituar 40% të çmimit të shitjes, por pa saktësuar apo dhënë informacion mbi mënyrën e lëvrimin të kësaj shume. Ndërsa në shpjegimet përfundimtare, përpara zhvillimit të seancës dëgjimore, subjekti vërtetoi me dokumentacion bankar pagesën për blerjen e këtij mjeti, ndërsa të ardhurat nga shitja i deklaroi të marra cash, për shkak të marrëdhënieve shoqërore me blerësin.*

*Komisioni konstaton se veprimi juridik i shitjes së mjetit është kryer midis dy individëve, që nuk ushtrojnë veprimtari tregtare, për pasojë nuk ekziston detyrimi ligjor për transfertën e çmimit nëpërmjet sistemit bankar. Ky detyrim ekziston vetëm për veprimet ndërmjet subjekteve tregtare.*

**23.2** Komisioneri Publik, lidhur me kontrollin e kryer mbi këtë pasuri, pretendoi hetim të paplotë në drejtim të blerjes në vitin 2010 të këtij automjeti në bashkëpronësi me të atin në raportet 40% me 60% dhe, në vijim, të shitjes së tij në vitin 2014 dhe kërkoi nga Kolegji kryerjen e hetimeve lidhur me këtë pasuri në drejtim të:

- (i) administrimit të dokumentacionit origjinal ose kopjeve të vërtetuara të tij, që provon pagesën e vlerës prej 21.000 eurosh ndaj shoqërisë në vitin 2010;
- (ii) konsiderimit të babait të subjektit të rivlerësimit si “person tjetër i lidhur” për efekt të ligjit nr. 84/2016, hetimin në lidhje me aftësitë e tij për të paguar një vlerë prej 12.600 eurosh në vitin 2010, për blerjen e këtij automjeti (sipas pjesës takuese, prej 60% të vlerës së blerjes);

- (iii) mospërputhjeve të konstatuara mes akteve të administruara gjatë hetimit për pagesat e kryera (15.000 euro nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe 6.000 euro nga babai i tij) dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me raportet e bashkëpronësisë;
- (iv) Vërtetimit të mënyrës së pagesës, në maj 2014, të çmimit të shitjes, 20.000 euro, për masën 60%, ndaj personit të lidhur, babait të subjektit të rivlerësimit.

**23.3** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimet e Komisionerit Publik, sa i takon hetimit të kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, duke pretenduar se provat e paraqitura prej tij në Komision nuk kanë qenë shkresa të thjeshta që nuk provojnë faktin e pagimit të çmimit të shitjes nga ana e blerësve, por kopje të mandatpagesave të nxjerra nga sistemi elektronik i bankës “{\*\*\*}”, me anë të të cilave provohet ndarja e çmimit në këste dhe pagimi i tij. Në lidhje me aftësinë paguese të të atit për të mbuluar pjesën takuese prej 60% të çmimit të blerjes së automjetit, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ky fakt është provuar gjatë hetimit të thelluar në Komision, si pasojë e veprimtarisë private profesionale të ushtruar nga i ati, nga viti 1993 e në vijim, në kuadër të së cilës ai ka siguruar të ardhura të mjaftueshme. Subjekti kundërshtoi gjithashtu edhe pretendimin e Komisionerit Publik, lidhur me mospërputhjet midis pagesave të kryera (vlerës së tyre) dhe raporteve të bashkëpronësisë, duke shpjeguar që angazhimi i tij në kryerjen e dy pagesave në vlerën totale prej 15.000 eurosh, lidhet me marrëdhënien e posaçme (prind-fëmijë) dhe moshën e tij më të re, krahasuar me të atin, për t’u marrë me këto veprime administrative dhe jo me mbulimin prej tij të pjesës takuese së të atit mbi çmimin e automjetit.

**23.4** Trupi gjykues, duke vlerësuar pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me këtë shkak ankimi në drejtim të dyshimit mbi aftësinë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për të përballuar blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, në pjesën takuese të çmimit të blerjes, prej 12.000 eurosh, si dhe duke e lidhur këtë dyshim jo vetëm me verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të subjektit mbi raportet e bashkëpronësisë dhe kontributin real të tij në blerjen e automjetit, sipas raportit të deklaruar të bashkëpronësisë, por edhe në drejtim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të z. B.I., për të financuar blerjen në datën 23.10.2014, të pasurisë së paluajtshme që u dhuroi fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi ta trajtojë këtë shkak ankimi të lidhur edhe me shkakun e paraqitur në lidhje me kontrollin e pasurisë së paluajtshme në pronësi të fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit dhe vendosi të hetojë pranë organeve tatimore, lidhur me të ardhurat e realizuara prej këtij të fundit nga aktiviteti profesional privat, i ushtruar nga viti 1993 e në vijim.

**23.5** Referuar rezultateve të këtyre hetimeve sipas trajtimit në paragrafëve 22.7 dhe 22.8 më sipër në vendim, trupi gjykues krijoi bindjen që babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të krijojë fillimisht në vitin 2010, pasurinë e luajtshme të llojit automjet, në bashkëpronësi me të birin (subjektin e rivlerësimit në raportet e bashkëpronësisë së deklaruara më sipër) dhe në vitin 2014, pas shitjes së këtij automjeti, të mund t’i investonte të ardhurat e realizuara nga shitja dhe kursimi i krijuar ndër vite, në financimin e blerjes së pasurisë së paluajtshme truall + ndërtesë, me sipërfaqe 106,7 m<sup>2</sup>, që ua dhuroi në vijim nipërve të tij në vitin 2017.

**23.6** Rezultatet e hetimit mbi nivelin e të ardhurave të realizuara nga babai i subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti profesional i kryer prej tij, të cilat konfirmuan pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi aftësinë paguese të babait të tij për përballimin e çmimit të automjetit, e bënë trupin gjykues të vlerësojë si të panevojshëm hetimin e mëtejshëm në drejtim të problematikave të tjera, duke i

trajtuar ato në kuadër të marrëdhënies së posaçme që ka ekzistuar mes palëve të përfshira në këtë transaksion shitblerjeje pasurie të luajtshme.

23.7 Në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit të shitjes së automjetit prej 20.000 eurosh në vitin 2014, sipas raporteve përkatëse të bashkëpronësisë, trupi gjykues kërkoi shpjegime të hollësishe në seancë nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me këstet e deklaruara për shlyerjen e çmimit të shitjes nga blerësi, z. L.Sh., vlerën e secilit prej tyre dhe momentin kohor të pagesës, shpjegime të cilat, së bashku me deklarimin e dhënë nga z. L.Sh. në prani të noterit publik, sipas deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., u vlerësuan të mjaftueshme në drejtim të nevojës për të përmbushur hetimin, lidhur me verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri të luajtshme, që ka qenë në bashkëpronësi të tij me të atin, gjatë periudhës 2010-2014. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin që vendimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri nuk është i cenueshëm, pasi veprimet e subjektit të rivlerësimit në krijimin e kësaj pasurie dhe pakësimin e saj si pasojë e shitjes në vitin 2014, nuk ngrenë dyshime në drejtim të vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të subjektit.

24. *Sa i takon shkakut të ankimit lidhur me verifikimin e saktësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit në raport me përdorimin e automjetit “Land Rover Discovery”, vit prodhimi 2012, në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me targa {\*\*\*}, Komisioneri Publik pretendoi që, duke qenë se Komisioni ka konstatuar mospërputhje sa i takon përmbajtjes së dokumentacionit shkresor të përcjellë nga AMF, në lidhje me periudhën e përdorimit të mjetit dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet të kishte hetuar duke marrë deklaramet e përfaqësuesve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në lidhje me raportin ligjor që ka ekzistuar mes shoqërisë dhe subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 49/4 të ligjit nr. 84/2016.*

24.1 Subjekti i rivlerësimit prapësoi pretendimin e Komisionerit Publik për detyrim për të deklaruar përdorimin e automjetit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, pasi sipas tij, përdorimi i automjetit ka qenë për periudha të shkurtra, duke mos plotësuar kriteret ligjore për t’u konsideruar subjekti i rivlerësimit në cilësinë e përdoruesit të mjetit, pavarësisht ekzistencës së policës së sigurimit me afat të gjatë.

24.2 Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit gjyqësor konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim<sup>16</sup> një automjet tip “Land Rover Discovery”, vit prodhimi 2012, në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me targa {\*\*\*}. Për efekt të përdorimit të këtij automjeti, subjekti i rivlerësimit ka prerë dy polica sigurimi njëvjeçare (TPL), përkatësisht për periudhat 22.09.2014 – 21.09.2015 dhe 15.10.2015 – 14.10.2016, dhe disa të tjera për periudha të shkurtra 02.09.2013 – 16.09.2013, 27.11.2016 – 11.12.2016, 30.07.2017 – 13.08.2017. Duke qenë se në momentin e dorëzimit<sup>17</sup> të deklaratës së pasurisë (*vetting*) nuk provohet nga aktet e fashikullit gjyqësor se subjekti ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, sikundër dhe nuk rezulton që të ketë pasur një policë sigurimi TPL të vlefshme në këtë moment kohor, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është në shkelje të detyrimit të deklaramit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim, dhe se çdo pasaktësi në deklaramet periodike të viteve të mëparshme, në drejtim të mosdeklaramit të interesit pasuror në formën e përdorimit të automjetit

<sup>16</sup> Siç rezulton nga kontrolli i regjistrit të sistemit TIMS dhe të dhënat e policave të sigurimit pranë AMF, përcjellë Komisionit në kuadër të hetimit të kryer lidhur me subjektin e rivlerësimit.

<sup>17</sup> Datë 31.01.2017.

në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për sa kohë nuk rezultoi gjatë hetimit administrativ nga Komisioni dhe atij gjyqësor në Kolegj ndonjë e dhënë në drejtim të ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi mes subjektit dhe shoqërisë në fjalë, këto pasaktësi nuk mund të vlerësohen si deklaram i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe si të tilla të mund ta bëjnë të cenueshëm vendimin e Komisionit në këtë drejtim.

25. Në lidhje me shkakun e ankimit mbi mangësitë në hetimin e kryer nga Komisioni, lidhur me pasuritë e luajtshme: (i) automjetin “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe (ii) automjetin “Opel Corsa”, vit prodhimi 1996, në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se:

**25.1** Komisioneri Publik pretendon hetim të paplotë nga Komisioni në drejtim të:

- (i) verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve mbi pronësinë e këtyre dy automjeteve nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses së tij, znj. S.T., për sa kohë lidhur me mjetin “Mercedes Benz”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, është deklaruar shitja në vitin 2010, ndërkohë që nga të dhënat e administruara gjatë hetimit në emër të subjektit ka rezultuar një policë sigurimi vjetor (TPL) për një automjet tip “Mercedes Benz”, për periudhën 28.01.2010 – 27.01.2011, ndërsa sa i takon automjetit “Opel Corsa”, ky automjet nuk është deklaruar më parë në pronësi të bashkëjetueses së subjektit, znj. S.T.;
- (ii) administrimit të kontratave të shitjes së këtyre dy sendeve, me qëllim konsiderimin e ligjshëm të të ardhurave të pretenduara se janë fituar në vlerën prej 7.000 eurosh.

**25.2** Subjekti i rivlerësimit prapësoi pretendimin e Komisionerit Publik për mosdeklarim nga bashkëjetuesja e tij të pronësisë mbi automjetin “Opel Corsa” si të pabazuar, duke qenë se, sipas tij, në deklaramin periodik të kryer në vitin 2005, personi i lidhur e kishte deklaruar rregullisht edhe këtë pasuri, si dhe pretendoi se kontratat e blerjes dhe shitjes së këtyre dy automjeteve janë depozituar rregullisht pranë ILDKPKI-së, me deklarimet periodike/vjetore përkatëse, si dhe deklaramtën e pasurisë (*vetting*) në vitin 2017.

**25.3** Në shqyrtimin e këtij shkakut ankimi, trupi gjykues çmoi të domosdoshme kryerjen e hetimit, me qëllim verifikimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet kërkesës për përcjellje informacioni dhe dokumentacioni provues nga ILDKPKI-ja lidhur me:

- (i) pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi deklaramin në deklaramtën e interesave privatë periodikë/vjetorë për vitin 2005 të blerjes së automjetit “Opel Corsa” nga ana e bashkëjetueses së tij, znj. S.T.; si dhe
- (ii) depozitimin pranë ILDKPKI-së të kontratave të blerjeve dhe të shitjeve, respektivisht për automjetet “Mercedes Benz” dhe “Opel Corsa”, përkatësisht të deklaruara në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses së tij.

**25.4** Trupi gjykues, në përfundim të hetimit lidhur me faktet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të kundërshtimit të shkakut të ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik, pasi dëgjoi pretendimin e palëve lidhur me rezultatet e hetimit, shqyrtoi dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja, vlerëson se nga hetimi i kryer u provua deklarami i rregullt e në përputhje me ligjin i këtyre dy automjeteve, si dhe u administruan edhe kontratat për shitblerjet përkatëse, në kuadër të shqyrtimit të ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga shitja e këtyre

automjeteve, rezultatet e të cilave pasqyrohen në analizën financiare, si më poshtë trajtuar në vendim.

26. *Në lidhje me shkakun e ankimit mbi mangësinë në hetimin e Komisionit, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave që janë përdorur për blerjen e automjetit “Hyundai”, vit prodhimi 2008, në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të mos ndalet në analizë të posaçme lidhur me këtë shkak ankimi, për sa kohë trajtimi i ligjshmërisë së të ardhurave për këtë automjet është pjesë e analizës financiare të vitit 2015, vit në të cilin është krijuar kjo pasuri, dhe vlerësohet në drejtim të mjaftueshmërisë së të ardhurave të ligjshme familjare për të kryer shpenzimet e vitit konkret dhe krijimin e pasurive të deklaruara për atë vit, për sa kohë burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë (vetting) është deklaruar “të ardhura familjare”.*
27. *Në lidhje me shkakun e ankimit mbi verifikimin e saktësisë së deklaramit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar kursimet e deklaruara në formën e likuiditetit “cash” jashtë sistemit bankar, trupi gjykues konstaton si më poshtë:*

**27.1** Komisioni, lidhur me saktësinë e deklaramit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për të krijuar kursimet *cash* ndër vite, është shprehur në vendim në kuadër të vlerësimit të krijimit të depozitës së kursimit në emër të subjektit të rivlerësimit pranë {\*\*\*} në shumën 20.000 euro dhe krijimit të depozitës së kursimit në emër të personit të lidhur (bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit) pranë bankës “{\*\*\*}” në shumën 15.000 euro dhe arsyeton përkatësisht:

*Me qëllim konfirmimin e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj depozite, më datë 05.02.2018, subjekti u pyet në lidhje me burimin e të ardhurave të ligjshme për këtë depozitë. Në përgjigjen e tij, të datës 15.02.2018, subjekti sqaron se si burim krijimi i kësaj depozite janë të ardhurat familjare, që përbëhen nga paga e tij dhe e bashkëjetueses. Për të vërtetuar këtë, bazuar mbi vërtetimet e pagave të subjektit dhe bashkëjetueses së tij, Komisioni bëri një analizë financiare të të gjitha të ardhurave, shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit dhe bashkëjetueses së tij gjatë viteve 2005-2016. Sipas tabelës së mëposhtme, rezulton se ai dhe bashkëjetuesja e tij kanë pasur burime të mjaftueshme të ardhurash për të hapur depozitat përkatëse, në shumën 20.000 euro pranë {\*\*\*}-së dhe 15.000 euro pranë bankës “{\*\*\*}”<sup>18</sup>.*

[...]

*Për të verifikuar saktësinë e këtij deklarimi, Komisioni kreu një analizë financiare të të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve familjare të subjektit, si dhe deklaramit të kursimeve “cash” ndër vite. Kjo analizë përputhet me atë të kryer nga ana e Komisionit për depozitën e kursimit në shumën prej 20.000 eurosh, në pronësi të subjektit.*

*Në konkluzion të analizës, vlerësojmë se subjekti dhe bashkëjetuesja e tij i kanë mbajtur në gjendje “cash” të gjitha kursimet e tyre ndër vite. Këto kursime janë deklaruar periodikisht pranë ILDKPKI-së. Në vitin 2016, të gjitha kursimet e grumbulluara kanë shërbyer si burim për të dyja depozitat e hapura, si nga subjekti, ashtu dhe nga bashkëjetuesja e tij<sup>19</sup>.*

**27.2** Në pjesën e fundit të vendimit, në përmbyllje të vlerësimit mbi kriterin e kontrollit të pasurisë, sa i takon analizës financiare, Komisioni arsyeton: *Nga analiza financiare e subjektit të rivlerësimit rezulton se të ardhurat familjare kanë qenë të mjaftueshme që të mbulojnë shpenzimet*

<sup>18</sup> Shih faqen 10 e vendimit të Komisionit.

<sup>19</sup> Shih faqen 18 e vendimit të Komisionit.



*ndër vite. Po sipas kësaj analize, subjekti rezulton me pamjaftueshmëri të ardhurash në vitin 2015. Komisioni, bazuar në shpjegimet dhe provat e subjektit, vlerëson se këto janë shpenzime të mbuluara nga të ardhurat e siguruara nga shitja e mjetit në vitin 2014. Ndërsa pamjaftueshmëria e të ardhurave për vitin 2016, nuk u mor në konsideratë nga Komisioni, sepse ishte një shumë e papërfillshme.*

**27.3** Komisioneri Publik, në lidhje me këtë shkak ankimi, pretendon se pasuria e krijuar ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të në formën e likuiditetit *cash*, jashtë sistemit bankar, nuk është hetuar në mënyrë të plotë nga Komisioni. Më konkretisht, sipas Komisionerit Publik konstatohet se një vlerë e deklaruar si e kursyer ndër vite, prej 4466990 lekësh<sup>20</sup>, e cila nuk mbulohet nga diferenca e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera, duhet të hetohet nga Kolegji në drejtim (i) të arsyes së ekzistencës së kësaj difference në lidhje me kursimet e deklaruara ndër vite me vlerën e deklaruar në deklaratën (*vetting*); (ii) të vendndodhjes eventuale të kësaj vlere monetare; dhe (iii) të burimit të ligjshëm për krijimin e këtyre kursimeve. Gjithashtu, Komisioneri Publik kërkoi hetimin edhe në drejtim të udhëtimeve të shumta të kryera nga subjekti i rivlerësimit jashtë territorit të Shqipërisë dhe deklarimit të adresave të sakta të familjarëve të subjektit në këto vende, ku pretendohet se ai ka qëndruar gjatë udhëtimeve jashtë vendit, me qëllim përlllogaritjen e shpenzimeve të kryera.

**27.4** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë shkak ankimi, kundërshtoi pretendimet e Komisionerit Publik me argumentin se konstatimet e tij lidhur me vlerat e pajustificuara dhe të padeklaruara në deklaratën e pasurisë (*vetting*) krijohen si pasojë e ndryshimeve në metodologjinë e përdorur për kryerjen e përlllogaritjeve si më poshtë:

- a) Llogaritjet e shpenzimeve për mobilim, sipas subjektit, nuk duhen shpërndarë në të gjitha vitet, duke qenë se pjesa më e madhe e tyre janë kryer në momentin e parë kur ka filluar të banojë në shtëpinë e mobiluar dhe në rastin e tij ky moment kohor pretendohet të jetë viti 2002.
- b) Në llogaritjet për udhëtimet jashtë Shqipërisë, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk është marrë parasysh fakti që pjesa më e madhe e tyre është kryer me autoveturë, si dhe pranë të afërmeve, ndërsa një pjesë tjetër e tyre ka lidhje me disa veprimtari të financuara nga një shoqatë kulturore, për të cilat disponohet dokumentacion justifikues.
- c) Të dhënat e INSTAT-it, për sa u përket shpenzimeve të jetesës, sipas subjektit, mënyra e shpërndarjes së tyre do të ishte më logjike të bazohet në metodën e përdorur nga ILDKPKI-ja, sipas së cilës shpenzimet të përcaktohen në varësi të kohës: për vitet më të hershme shpenzimet të jenë më të ulëta, sepse dhe kostoja e jetesës ka qenë më e ulët.
- ç) Përlllogaritja e kursimit të deklaruar në *cash* jashtë sistemit bankar, sipas subjektit të rivlerësimit: *ka një shpërqendrim lidhur me deklarimin e kursimeve të familjes sime në "cash", i cili vjen si pasojë e deklarimit tim në vite, ku në deklaratat periodike është deklaruar gjithmonë dhe vetëm pjesa që kursehet në të holla në dorë dhe nuk deklarohet sa ishte gjendja nga viti paraardhës. [...] pikërisht me ato të holla janë mbuluar pjesa e shpenzimeve të ndryshme, si udhëtimet etj. Ato që quhen mangësi në ankim nga Komisioneri, janë pikërisht të ardhurat që janë përdorur për të gjitha ato lëvizje apo nevoja të tjera të familjes. Me*

---

<sup>20</sup> Referuar rezultatit financiar të viteve 2005, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2015 të përlllogaritur nga Komisioneri Publik.

*depozitimin nga ana jonë të kursimeve në vitin 2016, gjendja jonë ka qenë zero në fund të atij viti, sepse siç e shpjegova më sipër është deklaruar vetëm kursimi vit pas viti dhe jo pakësimi.*

**27.5** Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku të ankimit, në vijim edhe të administrimit të dokumentacionit nga hetimi i kryer në Kolegj, trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm vendosi kryerjen e një analize ekonomiko-financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Kolegjit mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, për periudhën 2004-2016, në mënyrë që të pasqyroheshin në të edhe rezultatet e hetimit të kryer në Kolegj, për aq sa ato ndikonin këtë analizë.

**27.6** Duke qenë se pjesë e analizës financiare ishte edhe përlllogaritja e udhëtimeve jashtë vendit e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, dhe për periudhën 1 janar 2004 – 31 dhjetor 2007 në dosjen e administruar në Komision nuk kishte të dhëna lidhur me hyrje-daljet e tyre jashtë vendit, trupi gjykues vendosi të hetojë lidhur me këtë fakt, duke i kërkuar Drejtorisë së Policisë së Shtetit përcjelljen e të dhënave mbi hyrje-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë, sipas sistemit TIMS, për subjektin dhe personat e lidhur me të, për periudhën e sipërcituar.

**27.7** Në kushtet e mungesës së rregullimit të posaçëm ligjor e nënligjor për vlerësimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, për subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, trupi gjykues vlerësoi të arsyeshëm përcaktimin e metodologjisë për përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve, si në vijim.

#### *Metodologjia për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit*

Udhëtimet jashtë vendit do të evidentohen sipas të dhënave të sistemit TIMS, përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor të vitit/viteve për të cilin/për të cilat përlllogariten shpenzimet e udhëtimit.

Shpenzimet e përlllogaritura në valutë do të konvertohen në lekë sipas kursit mesatar vjetor të publikuar nga Banka e Shqipërisë, përveç rasteve kur kursi i këmbimit është përcaktuar shprehimisht në aktet shkresore justifikuese për transaksionin përkatës ose kur data e transaksionit është e provuar me akt shkresor, rast në të cilin do të aplikohen kurset e datës së kryerjes së transaksionit, sipas të njëjtit burim zyrtar.

#### *Shpenzimet e qëndrimit*

Shpenzimet e qëndrimit<sup>21</sup> për udhëtime jashtë vendit, për personat e rritur (18+ vjeç) llogariten në vlerën 50 euro/dollarë amerikanë<sup>22</sup> për çdo ditë qëndrimi, për fëmijët (5-18 vjeç) 25 euro/dollarë amerikanë për çdo ditë qëndrimi dhe për fëmijët (0 - ditën që mbush 5 vjeç) në vlerën 15 euro/dollarë amerikanë për çdo ditë qëndrimi.

<sup>21</sup> Për efekt të përcaktimit të kostove të qëndrimit jashtë Shqipërisë, është mbajtur në konsideratë legjislacioni i zbatueshëm në fuqi, lidhur me dietat, si: udhëzimi i ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”, seksioni 3.6 “Shpenzime të panjohura”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 8.5.2003, “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit”, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Në rastin në fjalë, në përlllogaritje janë zbatuar për analogji parashikimet e akteve nënligjore për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit.

<sup>22</sup> Monedha në të cilën do të përlllogariten shpenzimet përcaktohet në varësi të vendit të qëndrimit. Si rregull, për qëndrimin në një shtet të Evropës do të përdoret euroja, kurse për qëndrimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përdoret dollari amerikan.

Në rastet kur nga subjekti i rivlerësimit provohet se shpenzimet e qëndrimit për të dhe/ose personat e lidhur me të janë mbuluar nga persona të tretë, atij/atyre do t'u llogariten vetëm sasia e të hollave të xhepit prej 5 eurosh/dollarësh amerikanë.

### *Shpenzimet e transportit, sipas llojit*

#### A. Transporti ajror

*Në rastet e udhëtimeve brenda kontinentit evropian:*

- a) biletat e udhëtimeve vajtje-ardhje, me destinacion Italinë, përveç fluturimeve me operatorin ajror “{\*\*\*}”, përllogariten: (i) për të rritur (12<sup>+</sup> vjeç) në vlerën 100 euro; (ii) për foshnjat (0-2 vjeç) në vlerën 10 euro (10% e biletës së të rriturit); (iii) për fëmijët (2-12 vjeç) në vlerën 75 euro (75% e biletës së të rriturit);
- b) biletat e udhëtimeve vajtje-ardhje, për destinacionet ku aplikohet linjë direkte, përfshirë edhe destinacionin Itali, me operatorin ajror “{\*\*\*}”, përllogariten: (i) për të rritur (12<sup>+</sup> vjeç) në vlerën 180 euro; (ii) për foshnjat (0-2 vjeç) në vlerën 18 euro (10% e biletës së të rriturit); (iii) për fëmijët (2-12 vjeç) në vlerën 135 euro (75% e biletës së të rriturit);
- c) biletat e udhëtimeve vajtje-ardhje, për destinacionet me linjë transit, përllogariten: (i) për të rritur (12<sup>+</sup> vjeç) në vlerën 250 euro; (ii) për foshnjat (0-2 vjeç) në vlerën 25 euro (10% e biletës së të rriturit); (iii) për fëmijët (2-12 vjeç) në vlerën 187,5 euro (75% e biletës së të rriturit).

*Në rastet e udhëtimeve jashtë kontinentit evropian, biletat e udhëtimeve vajtje-ardhje për të rritur (12<sup>+</sup> vjeç) përllogariten në vlerën 600 dollarë amerikanë, për të foshnjat (0-2 vjeç) në vlerën 60 dollarë amerikanë (10% e biletës së të rriturit), si dhe për fëmijët (2-12 vjeç) në vlerën 450 dollarë amerikanë (75% e biletës së të rriturit).*

*Për udhëtime jashtë vendit me “charter”, si pjesë të një pakete turistike:*

- a) biletat e udhëtimeve vajtje-ardhje për të rritur dhe fëmijë mbi 12 vjeç përllogariten në vlerën 100 euro, ndërsa për fëmijë 0-12 vjeç (deri në ditën që mbushin moshën 12 vjeç) bileta e udhëtimeve nuk përllogaritet;
- b) shpenzimet e qëndrimit përllogariten për të rritur dhe fëmijë mbi 12 vjeç në vlerën 50 euro për çdo ditë qëndrimi, ndërsa për fëmijë 0-12 vjeç nuk përllogariten.

#### B. Transporti tokësor

Shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit me automjet, kur është i njohur/i deklaruar destinacioni, përllogariten sipas formulës: shpenzime totale udhëtimi = distanca (në km)  $\times$  konsum karburanti  $\times$  çmimi mesatar/litër + shpenzime për certifikatën ndërkombëtare të sigurimit të automjetit (karton jeshil).

Lidhur me këtë formulë, elementet përcaktohen si më poshtë:

- ° distanca në km evidentohet nga vendi i nisjes në vendin e mbërritjes nëpërmjet: [www.google.com/maps/dir/](http://www.google.com/maps/dir/);
- ° konsumi i karburantit merret në vlerë standarde prej 7 litra/100 km (për çdo lloj automjeti);

- çmimi mesatar për litër karburanti të konsumuar përlllogaritë bazuar në të dhënat e publikuara në <https://ec.europa.eu/energy/en/data-analysis/weekly-oil-bulletin> për llojin diesel/naftë (më konkretisht vlerat paraqiten sipas tabelës së mëposhtme, “Çmimi mesatar mujor i naftës për litër”).

Çmimi mesatar mujor i naftës për litër (në euro)												
MUAJI/VITI	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1. Janar	0,932	1,074	1,032	1,201	0,973	1,090	1,302	1,472	1,470	1,423	1,193	1,065
2. Shkurt	0,940	1,076	1,035	1,208	0,972	1,086	1,338	1,490	1,483	1,422	1,228	1,039
3. Mars	0,980	1,085	1,053	1,257	0,944	1,131	1,384	1,519	1,470	1,408	1,281	1,076
4. Prill	1,014	1,108	1,081	1,285	0,973	1,182	1,398	1,515	1,437	1,412	1,290	1,086
5. Maj	0,999	1,127	1,088	1,375	0,982	1,191	1,372	1,485	1,419	1,414	1,312	1,133
6. Qershor	1,034	1,117	1,101	1,435	1,024	1,197	1,360	1,437	1,420	1,421	1,303	1,163
7. Korrik	1,063	1,131	1,112	1,443	1,017	1,178	1,364	1,459	1,437	1,419	1,277	1,143
8. Gusht	1,075	1,137	1,109	1,362	1,049	1,178	1,364	1,526	1,446	1,410	1,212	1,122
9. Shtator	1,114	1,097	1,124	1,316	1,027	1,179	1,371	1,532	1,465	1,407	1,187	1,137
10. Tetor	1,122	1,059	1,146	1,234	1,030	1,186	1,387	1,518	1,436	1,374	1,177	1,162
11. Nëntor	1,070	1,049	1,215	1,134	1,055	1,209	1,414	1,493	1,421	1,347	1,180	1,164
12. Dhjetor	1,051	1,054	1,223	1,038	1,047	1,252	1,422	1,472	1,434	1,290	1,145	1,201
<b>TOTAL</b>	<b>1,032</b>	<b>1,094</b>	<b>1,108</b>	<b>1,283</b>	<b>1,008</b>	<b>1,170</b>	<b>1,370</b>	<b>1,494</b>	<b>1,445</b>	<b>1,399</b>	<b>1,236</b>	<b>1,123</b>

*Burimi:* <https://ec.europa.eu/energy/en/data-analysis/weekly-oil-bulletin>

*Shpenzimet për certifikatën ndërkombëtare të sigurimit të automjetit (karton jeshil) përlllogariten:*

- 0 euro për destinacionin Kosovë;
- 15 euro për destinacionin Mali i Zi;
- 40 euro për vende të tjera.

Në rast mungese të informacionit për destinacionin e saktë të udhëtimit dhe për pikën kufitare të daljes, shpenzimet për kartonin jeshil përlllogariten në vlerën 15 euro.

Për udhëtimet jashtë vendit me automjet, kur nuk është deklaruar destinacioni i saktë, por verifikohet pika kufitare e daljes, konsiderohet si destinacion qyteti më i afërt me kufirin dhe përlllogaritjet kryhen si më sipër. E njëjta mënyrë vlerësimi ndiqet edhe në rastet kur nuk është deklaruar destinacioni i saktë (qyteti), por vetëm vendi i hyrjes dhe, në këtë rast, si destinacion merret qyteti më i afërt nga pika kufitare për në vendin e hyrjes dhe përlllogaritjet e shpenzimeve kryhen si më sipër.

Në të gjitha rastet kur udhëtimi është kryer me automjet, por nuk identifikohet pika kufitare e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, si e tillë do të konsiderohet vendkalimi kufitar më i afërt me vendbanimin e subjektit të rivlerësimit/personit të lidhur dhe përlllogaritjet e shpenzimeve të udhëtimit do të kryhen si më sipër.

Në rastet kur subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur me të kanë udhëtuar me automjet të cilin nuk e kanë në pronësi/përdorim dhe provojnë se kanë qenë pasagjerë, shpenzimet e transportit nuk do të përlllogariten.

### C. Transporti detar

Për shpenzimet e udhëtimit me traget:

- çmimi i biletës si për një të rritur, ashtu edhe për një fëmijë përlllogaritet në vlerën 50 euro vetëm për një drejtim (vajtje ose ardhje);

° çmimi i biletës për një makinë përlllogaritet në vlerën 60 euro për vetëm një drejtim (vajtje ose ardhje).

**27.8** Në seancën e datës 12.02.2019, palëve iu vu në dispozicion analiza ekonomiko-financiare për subjektin e rivlerësimit Edmond Islamaj dhe personat e lidhur me të për periudhën 2004-2016, pjesë integrale e së cilës ishte edhe Aneksi 1, analiza e zërit “Shpenzime për udhëtime jashtë Shqipërisë për periudhën janar 2004 - tetor 2016”. Trupi gjykues i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegojë bindshëm burimet financiare të ligjshme që justifikojnë shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara në vitet që, sipas kësaj analize, kanë rezultat financiar negativ, në vlerën totale prej 5.382.654 lekësh<sup>23</sup>.

**27.9** Lidhur me analizën ekonomiko-financiare, subjekti i rivlerësimit fillimisht deklaroi në seancë se ka përgatitur me shkrim një analizë të tijën ekonomiko-financiare në formë tabelare, në të cilën ka parashtruar të dhënat për faktet financiare relevante, analizën ekonomike dhe observacionet e tij rreth analizës ekonomiko-financiare të paraqitur nga trupi gjykues, të cilën e shoqëroi me disa dokumente, deklarata noteriale e dokumente zyrtare që kërkoi të pranohen si prova.

**27.10** Në vazhdim, subjekti i rivlerësimit parashtroi shpjegimet dhe kundërshtimet e tij lidhur me analizën ekonomiko-financiare të Kolegjit, duke pretenduar përmbledhtazi sa më poshtë.

#### *Lidhur me shpenzimet e jetesës*

**27.10.1** Subjekti, në lidhje me shpenzimet e familjes së tij, kundërshtoi përdorimin e referencës në të dhënat e INSTAT-it, sipas Anketave të Buxhetit të Familjes, vetëm për vitet 2004, 2005 dhe 2006, me argumentin se për këtë periudhë nuk ka pasur një vrojtim të tillë statistikor në formën e Anketës së Buxhetit të Familjes, për sa kohë kjo anketë i përket vetëm vitit 2007 dhe, për rrjedhojë, një përlllogaritje e tillë, sipas subjektit të rivlerësimit, është e padrejtë, e paarsyeshme dhe e paargumentuar ligjërisht.

#### *Lidhur me udhëtimet e subjektit të rivlerësimit*

**27.10.2** Subjekti kundërshtoi llogaritjen e shpenzimeve ditore për periudhat kur ka qëndruar te të afërmit, si dhe mosllogaritjen si shpenzim të kryer nga subjekti të çmimit të kartonit jeshil, i cili në shumicën e rasteve ka qenë i paguar nga persona të tretë, për sa kohë subjekti ka përdorur automjetet e tyre.

**27.10.3** Subjekti pretendoi se i janë llogaritur shpenzime të njëjta, si në rastet kur ai ka udhëtuar brenda ditës, edhe kur ka qëndruar jashtë shtetit.

#### *Lidhur me mënyrën e deklarimit në vite të kursimeve të tij dhe të familjes së tij*

**27.10.4** Subjekti pretendoi se diferenca negative që ka rezultuar nga analiza ekonomiko-financiare lidhet me mënyrën e tij të deklarimit ndër vite të kursimeve. Subjekti pretendoi për se nga ana e tij ka pasur “moskuptim të saktë të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003” dhe se ai ka deklaruar vetëm shtesat në kursime, që korrespondojnë me të ardhurat e kursyera gjatë vitit.

---

<sup>23</sup> Referuar analizës financiare, totali i diferencës së pajustificuar prej 5.382.654,82 lekësh vjen si pasojë e rezultatit negativ të viteve nga 2004-2016, me përjashtim të vitit 2014.

**27.10.5** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se kursimet e tij janë në masë shumë më të vogël nga sa rezultojnë nga mbledhja aritmetike e deklarimeve ndër vite dhe kjo lidhet me mosdeklarimin nga ana e tij të shpenzimeve që ka kryer gjatë vitit, të cilat në mungesë të rubrikës përkatëse në formularët e deklarimit, nuk i ka deklaruar.

**27.10.6** Subjekti pretendoi se kjo situatë është konstatuar edhe nga ILDKPKI-ja, për të cilën ai ka dhënë të njëjtat shpjegime dhe, në mbështetje të këtij pretendimi, dorëzoi edhe një procesverbal të mbajtur nga inspektori përkatës, më datë 11.04.2016, si dhe kopje të dy kontratave të depozitave me afat, të çelura nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesja e tij në datën 19.04.2016, përkatësisht pranë {\*\*\*} në vlerën 20.000 euro dhe pranë bankës "{\*\*\*}" në vlerën 15.000 euro.

**27.11** Lidhur me analizën ekonomiko-financiare për subjektin e rivlerësimit Edmond Islamaj dhe personat e lidhur për periudhën 2004-2016, Komisioneri Publik kundërshtoi këtë analizë në drejtim të përcaktimit të burimeve të ligjshme të të ardhurave për periudhën 2004-2016, duke pretenduar sa më poshtë.

**27.11.1** Në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nuk duhet të llogariten si të ardhura të ligjshme të ardhurat e realizuara nga shitja e automjeteve të llojit "Mercedes Benz" dhe "Opel Corsa", pasi këto transaksione shitjeje kanë rezultuar me fitim për subjektin e rivlerësimit dhe për këto të ardhura nuk rezulton të jenë përmbushur detyrimet tatimore përkatëse, lidhur me pjesën e fitimit të realizuar.

**27.11.2** Nuk duhet të llogariten si të ardhura të ligjshme, të ardhurat e deklaruara nga shitja e automjetit të llojit "Land Rover" në vitin 2014 në vlerën 20.000 euro, për sa kohë kjo pagesë nuk është kryer nëpërmjet sistemit bankar, sikundër është parashikuar në kontratën e shitjes.

**27.12** Trupi gjykues, në vlerësim të pretendimeve të palëve, lidhur me metodologjinë e përdorur në kryerjen e analizës ekonomiko-financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, shqyrtimit të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të reduktimit të shpenzimeve të përlllogaritura, kryesisht atyre të udhëtimit për të dhe familjarët e tij, vlerëson sa vijon.

**27.12.1** Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të justifikimit të shpenzimeve të kryera për një pjesë të udhëtimeve jashtë Republikës së Shqipërisë në formën e deklaratës noteriale, u trajtua nga trupi gjykues në kuadër të dokumentit shkresor, në kuptim të nenit 49, pika 1, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016, si shkresë e thjeshtë dhe jo si provë me dëshmitarë, në kuptim të pikës 1, shkronja "b" e të njëjtit nen. Vlera provuese e këtyre deklaratave u vlerësua nga trupi gjykues rast pas rasti, në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të dhëna në to me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision dhe atij në Kolegj. Për rrjedhojë, u reduktuan shpenzimet për udhëtimet jashtë Shqipërisë, si pasojë e provave të paraqitura nga subjekti, lidhur me udhëtimet e tij në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga shoqata kulturore "{\*\*\*}", me udhëtimet zyrtare të subjektit dhe bashkëjetueses së tij, si dhe me një pjesë të udhëtimeve pranë familjarëve, me përjashtim të sa më poshtë vijon.

(i) Deklaratës noteriale të datës 20 shkurt 2019, të z. G. dhe znj. D.T., përpara noterit publik të shtetit të Floridës, znj. C.T., lidhur me udhëtimin e subjektit dhe familjes së tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në datat 17 korrik - 28 gusht 2014, pasi deklarimi i tyre bie ndesh me

deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2014, sipas së cilës shpenzimet e deklarueshme për pushime për subjektin kanë qenë 3000 dollarë amerikanë. Sa i takon deklarinimit të këtyre dy personave lidhur, me mbulimin e shpenzimeve për udhëtimin e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të në datat 24 nëntor – 15 dhjetor 2011, deklarimi do të pranohet vetëm për mbulimin e kostove të qëndrimit dhe, për rrjedhojë, subjektit dhe personit të lidhur, sipas metodologjisë së sipërcituar, do t'u përlllogariten vetëm shpenzimet ditore prej 5 dollarësh amerikanë për çdo ditë qëndrimi, ndërsa sa u takon shpenzimeve të udhëtimit, ato do të llogariten në ngarkim të subjektit, për sa kohë blerja e biletave prej të afërmeve nuk është deklaruar prej tij në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2011, në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”.

(ii) Urdhrave të kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. {\*\*\*}, datë 02.03.2004, nr. {\*\*\*}, datë 25.02.2005, nr. {\*\*\*}, datë 05.03.2009, “Për dhënien e shpërblimit me rastin e festës së 8 Marsit, pasi u vlerësuan të panevojshëm, duke qenë se e ardhura e caktuar në këta urdhra në formën e shpërblimit me rastin e festës së gruas, është marrë parasysht në kuadër të të ardhurave nga paga dhe shpërblimeve të tjera nga institucioni punëdhënës.

**27.12.2** Sa i takon zërit të shpenzimeve të jetesës në analizën ekonomiko-financiare, trupi gjykues konstaton se përlllogaritja e tyre është kryer sipas së njëjtës metodologji të përdorur nga Komisioni, referuar të dhënave të konsumit të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF), sipas Anketës së Buxhetit të Familjes, të publikuar nga INSTAT, për të cilën subjekti nuk rezulton t'i ketë kundërshtuar këto të dhëna as në momentin kur, së bashku me “Rezultatet e hetimit për subjektin e rivlerësimit, z. Edmond Islamaj”, i është përcjellë edhe analiza financiare e kryer nga Komisioni në formë tabelare, pjesë e së cilës janë edhe shpenzimet e jetesës, as gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni, sikundër as pas dhënies së vendimit të Komisionit, në formën e ushtrimit të ankimit për kundërshtimin e kësaj mënyre llogaritjeje, të pretenduar prej tij si të padrejtë, të paarsyeshme dhe të paargumentuar ligjërisht.

**27.12.3** Megjithatë, në analizë të këtij pretendimi të subjektit, referuar të dhënave të INSTAT-it, rezulton se vrojtime statistikore pranë Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) duke prodhuar shifrat zyrtare të Anketës së Buxhetit të Familjes (në vijim ABF) që rezulton të jetë kryer për herë të parë në vitet 1999-2000, anketë kjo e cila ishte përfaqësuese vetëm për zonat urbane, për të vazhduar më pas në vitet 2006-2007, 2008-2009 dhe që nga viti 2014 në mënyrë të vazhdueshme. Nga viti 2006-2007, anketa është kryer në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe me përfaqësim në nivel qarku.

**27.12.4** Në analizën ekonomiko-financiare që iu paraqit subjektit të rivlerësimit, në pjesën hyrëse të dokumentit përcaktohet: *Shpenzimet për konsum familjar janë përlllogaritur me të njëjtën metodologji të përdorur nga Komisioni, referuar të dhënave të INSTAT-it për “Shpenzime mujore për konsum, sipas madhësisë së Njësive Ekonomike Familjare” publikuar në: <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes>. Për vitet 2004-2005, për të cilat nuk ka të dhëna nga INSTAT, janë aplikuar vlerat e tabelës “Shpenzime mujore për konsum, sipas madhësisë së Njësive Ekonomike Familjare”, për familje me tre persona (viti 2006 si e dhënë fillestare referuese), ndërsa për vitet e tjera pa të dhëna, është aplikuar mesatarja aritmetike e vlerave të viteve më të afërta me të dhëna zyrtare.*

**27.12.5** Në vijim të sa më sipër, në shqyrtim të pretendimit të subjektit për mospërdorimin e referencës në të dhënat e INSTAT-it, sipas Anketave të Buxhetit të Familjes, vetëm për vitet 2004, 2005 dhe 2006, me argumentin se për këto vite nuk ka pasur vrojtime statistikore në formën e

ABF-së, por ka pasur vrojtime në drejtim të shpenzimeve familjare të kryera nga INSTAT-i, në formën e Anketës për Matjen e Nivelit të Jetesës (AMNJ) për vitet 2002 dhe 2005, trupi gjykues vlerëson sa vijon.

i) Në referencë të të dhënave të marra nga faqja zyrtare e INSTAT-it mbi Anketën e Buxhetit të Familjes, konstatohet se vite pa të dhëna të një vrotimi të tillë nuk janë vetëm vitet 2004 dhe 2005, por edhe vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013. Subjekti pretendoi se aplikimi i të dhënave të ABF-së 2006-2007 edhe në vitet 2004 dhe 2005 është disfavorizues për të, pasi cenon situatën e tij ekonomiko-financiare, si pasojë e përdorimit të të dhënave më të larta të konsumit, që nuk i përgjigjen realitetit dhe, për rrjedhojë, kërkoi përdorimin për këto vite të Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës, por nuk kundërshtoi në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin argument, përdorimin e të dhënave të kësaj ankete edhe për vitet e tjera pa të dhëna nga ABF-ja dhe, në mënyrë të veçantë, për shembull, për vitin 2012, ku rezultoi që për këtë vit të ketë pasur Anketë të Matjes së Nivelit të Jetesës dhe jo ABF, edhe pse rezultati financiar i vitit ishte me diferencë negative të konsiderueshme, në vlerën prej -1.341.521 lekësh.

ii) Këto dy anketime, referuar metodologjive të tyre sipas publikimeve<sup>24</sup> të INSTAT-it, kanë qëllime të ndryshme vrotimi dhe monitorimi dhe, për rrjedhojë, shifrat e raportuara prej tyre në drejtim të matjes së konsumit të familjes, janë të ndryshme, ku për shembull, për vitin 2008, vit në të cilin janë kryer nga INSTAT-i të dyja këto anketime, rezultoi se sipas AMNJ-së, vlera e shpenzimit mesatar mujor për frymë paraqitet në 9.966 lekë në muaj, ndërsa sipas ABF-së, vlera e shpenzimit mujor për konsum për familje me një person paraqitet në vlerën 31.397 lekë.

iii) Në vështrim të sa më sipër, vlerat e publikuara sipas AMNJ-së, janë dukshëm më të ulëta se ato sipas ABF-së, çka e bën në pamje të parë, të pakuptimtë dhe alogjike për trupin gjykues, kërkesën e subjektit për mospërdorimin e shifrave sipas ABF-së vetëm për vitet 2004, 2005 dhe 2006, ndërkohë që shtrirja e standardit të AMNJ-së edhe për vitet e tjera, do t'i ulte dukshëm shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit. Për ilustrim, në vitin 2012 nuk ka pasur të dhëna nga ABF-ja, por ndërkohë kemi të dhëna nga AMNJ-ja. Nëse do të përdornim të dhënat e këtij anketimi në analizën ekonomiko-financiare, shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit me 4 persona, do të reduktoheshin në 475.728 lekë në muaj, nga 922.200 lekë<sup>25</sup> në muaj dhe diferenca e pajustificuar prej -1.341.521 lekë, për këtë vit financiar do të zvogëlohej në -895.049 lekë. Subjekti i rivlerësimit në analizën ekonomiko-financiare të prezantuar prej tij, e ka pranuar përllogaritjen e bërë nga Kolegji lidhur me shpenzimet e jetesës bazuar në ABF-në, por ka pretenduar se ka zvogëluar kursimet e tij *cash* nga vitet e mëparshme në shumën prej 1.400.000 lekësh<sup>26</sup>. Nëse subjekti do të kishte kërkuar edhe për këtë vit aplikimin e vlerave të AMNJ-së, si referencë për llogaritjet e shpenzimeve të jetesës së familjes së tij, kjo do të sillte si pasojë reduktimin e diferencës së pajustificuar, rritjen e vlerës së justifikuar të kursimit të deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur me të për vitin 2012, por nga ana tjetër do të reduktonte nevojën e subjektit për të zvogëluar vlerën e likuiditetit të akumuluar në *cash* nga vitet e mëparshme, të pretenduar prej tij si të përdorur, në shumën prej 1.400.000 lekësh, për të mbuluar diferencën e pajustificuar prej -1.341.521 lekësh, që rezultoi nga analiza financiare për këtë vit.

<sup>24</sup> Shih <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/>  
<http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-matjes-s%C3%AB-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs/>

<sup>25</sup> Të përllogaritura në analizën ekonomiko-financiare të Kolegjit.

<sup>26</sup> Referuar f. 9 të materialit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, me lëndë "Përgjigje të relacionit përmbledhës të analizës ekonomiko-financiare të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të datës 12.02.2019".



**27.12.6** Nga analiza e mësipërme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se arsyeja e vërtetë se përse subjekti i rivlerësimit nuk kundërshtoi analizën e Kolegjit lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës sipas ABF-së, për të gjitha vitet që nuk ka të dhëna zyrtare sipas këtij anketimi, ishte në funksion të mbështetjes së tezës së tij, të pabazuar në ligj, se pasuria e realizuar prej tij në formën e kursimit *cash* jashtë sistemit bankar nuk ishte shuma aritmetike e deklarimeve periodike, pasi ajo pakësohej për efekt të mbulimit të shpenzimeve gjatë viteve. Pra, nëse subjekti në analizën e tij financiare do të pretendonte uljen e shpenzimeve të jetesës për të gjitha vitet, kjo gjë do të sillte si pasojë reduktimin e ndjeshëm të nevojës së tij për të pakësuar pasurinë e akumuluar në formën e *cash*-it dhe, si pasojë, kjo pasuri *cash* duhet të ishte deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

**27.12.7** Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e konsideroi të pabazuar dhe, për rrjedhojë, të papranueshëm këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit.

**27.12.8** Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se analiza financiare duhet të bazohet në të njëjtën metodologji dhe vlerë përlllogaritjeje shpenzimesh, siç vepron organi i posaçëm për këtë qëllim, ILDKPKI-ja, pretendim ky i ngritur nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë gjatë konkluzioneve përfundimtare, pasi ishte deklaruar edhe mbyllja e hetimit gjyqësor nga trupi gjykues, çmohet prej këtij të fundit si një pretendim haptazi në kundërshtim të plotë me mënyrën e mbrojtjes që realizoi vetë subjekti në proces, teksa konstatohet se, sa i takon mënyrës së përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, ai kundërshtoi përlllogaritjet e Kolegjit vetëm për vitet 2004, 2005 dhe 2006, duke pranuar në mënyrë të shprehur përlllogaritjet në analizën ekonomiko-financiare të Kolegjit për vitet e tjera, sipas qëndrimit të mbajtur në faqet 4-13 të materialit të tij, bashkëlidhur prapësimeve ndaj analizës ekonomiko-financiare me lëndë “Përgjigje të relacionit përmbledhës të analizës ekonomiko-financiare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit të datës 12.02.2019” dhe, duke i kthyer ato në përlllogaritjet e tij të shpenzimeve të jetesës, sipas rubrikës “Konsumi”, në zërin “Shpenzime”, në tabelat me titull “Sipas subjektit të rivlerësimit”, në faqet 4-13 të materialit të tij, si më sipërcituar. Përveç sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës sipas vlerës së përlllogaritur nga ILDKPKI-ja në raportin e saj nr. {\*\*\*} prot., datë 16.11.2017, në rreth 9.000.000 lekë, përveçse përbën një pretendim, i cili nuk i është nënshtruar debatit gjyqësor dhe, si i tillë, nuk mund të pranohet, vlerësohet se e vendos subjektin në të njëjtën pozitë të disfavorshme, si parashtruar në paragrafin 27.12.6, në raport me mosdeklarimin e kursimit *cash*, që do t'i rezultonte gjendje e mbetur në fund të vitit 2016, si pasojë e reduktimit të ndjeshëm të shpenzimeve të jetesës në nivelin e vlerës së deklaruar në raportin e ILDKPKI-së.

**27.12.9** Sa u takon pretendimeve për shpenzime të pakryera për kartonin jeshil, trupi gjykues çmon se një pretendim i tillë mund të merret në konsideratë vetëm në ato raste kur provohet nga subjekti i rivlerësimit se ky shpenzim nuk është kryer prej tij. Subjekti nuk paraqiti asnjë provë për vërtetimin e këtij pretendimi.

**27.12.10** Sa i takon përlllogaritjes së njëjtë të shpenzimeve, si në rastet kur subjekti ka qëndruar jashtë, edhe në rastet kur ai rezulton të jetë kthyer brenda ditës, trupi gjykues vlerëson se shpenzimet e qëndrimit të përlllogaritura në analizën financiare, përfaqësojnë vlerën më të ulët të shpenzimit për ditë qëndrimi dhe, pavarësisht kthimit apo jo brenda ditës, ajo vlerësohet si vlera minimale e nevojshme për një shpenzim ditor, për sa kohë subjekti nuk arrin të provojë të kundërtën.

**27.12.11** Gjithashtu, të njëjtin qëndrim mban trupi gjykues në drejtim edhe të shpenzimeve minimale të qëndrimit, të llogaritura në vlerën e 5 euro/dollarëve në ditë (në rastet kur shpenzimet e qëndrimit mbulohen nga palë të treta), e cila vlerësohet si sasia e të hollave të xhepit, me vlerë të njëjtë me nevojën për konsum uji të pijshëm dhe transporti urban.

**27.12.12** Sa u takon pretendimeve të Komisionerit Publik lidhur me moskonsiderimin si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të ardhurat e realizuara nga shitja e dy automjeteve, për sa kohë rezulton që subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim prej këtyre transaksioneve, trupi gjykues, në vlerësim të parashikimeve të nenit 8, pika 1, shkronja “g” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merret si e ardhur e tatueshme çdo e ardhur tjetër e realizuar nga individë rezidentë, që nuk identifikohet në format e paraqitura në këtë nen dhe për sa kohë e ardhura e realizuar nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i Komisionerit Publik është pjesërisht i bazuar në ligj, vetëm për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë iu zbrit së ardhurës të arkëtuar nga shitja e këtyre automjeteve, duke u pasqyruar në rezultatin financiar të vitit përkatës.

**27.12.13** Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik për të mos pranuar si të ardhur të ligjshme të ardhurat e deklaruara nga shitja e automjetit të llojit “Land Rover” në vitin 2014, në vlerën prej 20.000 eurosh, për sa kohë kjo pagesë nuk është kryer nëpërmjet sistemit bankar, sikundër është parashikuar në kontratën e shitjes, trupi gjykues çmon se, për sa kohë pagesa midis individëve për kryerjen e këtij transaksioni nëpërmjet sistemit bankar nuk ka qenë detyrim ligjor në kohën e kryerjes së transaksionit, nuk e bën të paligjshëm arkëtimin e çmimit të shitjes jashtë sistemit bankar, pavarësisht mosrespektimit faktik të parashikimeve kontraktore mbi mënyrën e kryerjes së pagesës.

**27.12.14** Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën e deklarimit të kursimeve të familjes së tij ndër vite, trupi gjykues sheh të nevojshme marrjen në analizë të legjislacionit në fuqi, lidhur me deklarimin e pasurive dhe interesave privatë. Referuar nenit 5/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Deklarimi para fillimit të detyrës” dhe ish-nenit 6<sup>27</sup> “Deklarimi i parë”, të cilët për nga natyra e deklarimit janë të njëjtë, përcaktohet detyrimi i subjekteve deklaruese për të deklaruar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit apo në vijim, nga momenti i fillimit të detyrës, të gjitha pasuritë e akumuluar dhe detyrimet financiare të tyre. Referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e të njëjtit ligj, në objektin e deklarimit, sipas kësaj dispozite, përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje *cash*, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri.

**27.12.15** Gjithashtu, neni 7 i të njëjtit ligj<sup>28</sup> përcakton në mënyrë të shprehur se në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë

<sup>27</sup> Tashmë i shfuqizuar si dispozitë e pazbatueshme, pasi lidhej vetëm me deklarimin e parë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit.

<sup>28</sup> Para miratimit të përmbajtjes aktuale të këtij neni, me miratimin e ligjit nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”, ky detyrim ligjor përcaktohej shprehimisht në të njëjtën mënyrë nga neni 15, pika 7 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji. Në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore, janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklarimeve periodike, të cilat në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave privatë, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit, udhëzojnë: *Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesat pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.*

**27.12.16** Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se legjislacioni në fuqi që përcakton mënyrën, llojin, objektin dhe afatin e deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë ka qenë më se i qartë në drejtim të përcaktimit të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së deklarimit. Mënyra e deklarimit periodik ka mbetur e pandryshuar, pavarësisht ndryshimeve që mund të kenë pësuar ndër vite ligjet e zbatueshme, lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe konfliktin e interesave dhe, për rrjedhojë, subjekti nuk ka qenë asnjëherë në kushtet e paqartësisë ligjore në drejtim të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së këtij deklarimi. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë edhe në drejtim të pasojave ligjore për subjektet në rast të deklarimit të të dhënave të rreme, për sa kohë në nenin 38 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, parashikohet shprehimisht: *Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën veprë penale sipas legjislacionit në fuqi.* Trupi gjykues e vlerëson ekzistencën e këtij parashikimi ligjor si një element përcaktues ndërgjegjësimit të subjekteve deklaruese në drejtim të rëndësisë së procesit dhe deklarimeve të tyre, çka nuk mund të justifikojë pretendimin e subjektit për “moskuptim të saktë të ligjit”, mbi të gjitha, në rastet kur ligji është i shprehur qartë dhe subjekti deklarues ka nivel të lartë të njohurive ligjore, duke qenë se është gjyqtar karriere dhe anëtar i Gjykatës së Lartë, juridiksioni i së cilës përfshin shqyrtimin e rekurseve ndaj vendimeve gjyqësore për zbatim të gabuar të ligjit.

**27.12.17** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se e njëjta çështje është ngritur edhe pranë ILDKPKI-së, në vijim të analizës së mësipërme ligjore, çmohet nga trupi gjykues pa efekt në drejtim të sjelljes së subjektit ndaj detyrimeve ligjore në fuqi, madje edhe evidentimi pranë ILDKPKI-së i kësaj mënyre deklarimi të subjektit nuk përbën detyrim për Kolegjin, i cili vendimmarrjen e tij e bazon në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për faktet e provuara gjatë gjykimit. Pavarësia e veprimeve hetimore dhe e vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit, sa u takon çështjeve të rivlerësimit kalimtar është konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**27.12.18** Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e tij të deklarimeve të kursimeve në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por edhe pretendim alogjik në kuptim të nocionit të kursimit. Në përfundim, trupi gjykues çmon se analiza ekonomiko-financiare në formë tabelare, e paraqitur nga subjekti, nuk ka vlerë provuese në drejtim të mënyrës së deklarimit të kursimeve të subjektit dhe të personave të lidhur me të, si dhe të mënyrës së përdorimit prej tyre të këtyre kursimeve. Për rrjedhojë, këto kursime në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shitesat dhe pakësimet e tyre, do të merren parasysh nga trupi gjykues, sipas deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, në deklaratat periodike/vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

27.12.19 Për rrjedhojë, pas reflektimit në përlogaritje edhe të qëndrimit të trupit gjykues ndaj pretendimeve të palëve, sipas konsideratave në paragrafët e mësipërm, rezultatet e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit rezultuan si më poshtë.

TABELA 1

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE FINANCIARE VJETORE PËR PERIUdhËN E RIVLERËSIMIT							
VITI	TË ARDHURAT	SHPENZIMET	KURSIMI I DEKLARUAR (CASH)	KURSIMI NË LLOGARI RRJEDHËSE BANKARE	KURSIMI TOTAL	KURSIMI I MUNDSHËM	DIFERENCA
	I	II			III	IV= I - II	IV - III
2004	2.177.545	2.430.841	0	39.995,67	39.995,67	-253.296,00	-293.291,67
2005	1.874.192	955.925	1.100.000	28.749,64	1.128.749,64	918.268	-210.482,05
2006	1.975.105	1.056.429	1.170.500	14.961,19	1.185.461,19	918.676	-266.785,19
2007	1.886.669	1.550.209	500.000	-23.032,63	476.967,37	336.460	-140.507,37
2008	2.069.054	1.130.201	1.100.000	120.418,64	1.220.418,64	938.853	-281.565,64
2009	2.538.778	1.189.706	1.400.000	118.399,30	1.518.399,30	1.349.072	-169.327,30
2010	3.688.087	2.328.726	1.663.370	78.542,50	1.741.912,50	1.359.361	-382.551,50
2011	2.667.189	1.498.373	1.450.000	124.702,64	1.574.702,64	1.168.816	-405.886,64
2012	2.367.601	1.872.289	1.110.000	614.211,46	1.724.211,46	495.312	-1.228.899,46
2013	2.427.434	1.506.012	700.000	243.166,96	943.166,96	921.422	-21.744,96
2014	3.080.454	2.168.859	150.000	317.370,54	467.370,54	911.595	435.224,46
2015	1.581.098	2.443.137	150.000	-84.085,94	65.914,06	-862.039	-927.953,06
2016	1.566.462	1.869.859	0	-264.589,12	-264.589,12*	-303.397	-38.807,88
<b>TOTAL</b>	<b>29.899.668</b>	<b>22.000.566</b>	<b>10.493.870</b>	<b>1.328.811</b>	<b>11.822.681</b>	<b>7.899.103</b>	<b>-4.367.802,72</b>
<b>TOTALI I DIFERENCËS SË PAJUSTIFIKUAR (NË LEKË)</b>							<b>-4.367.802,72</b>

TABELA 2

ANALIZË E ECURISË SË GJENDJES SË KURSIMEVE NË CASH, DUKE REFLEKTUAR NË TO PAKËSIMIN E TYRE, SIPAS DEKLARIMEVE PERIODIKE TË SUBJEKTIT DHE BASHKËJETUESËS SË TIJ							
VITI	KURSIMIT E DEKLARUARA NGA SUBJEKTI (LEKË)	KURSIMIT NGA PAGA, DEKLARUAR NGA B/JETUESJA (LEKË)	KURSIME NGA QIRAJA ,DEKLARUAR NGA B/JETUESJA (LEKË)	KURSIME NGA SHITJA E AUTOMJETIT "OPEL" (LEKË)	KURSIMI I DEKLARUAR CASH JASHTË SISTEMIT BANKAR (LEKË)	KURSIME TË PËRDORURA SIPAS DEKLARIMEVE (LEKË)	DIFERENCA (CASH) (LEKË)
	I	II	III	IV	V=I+II+III+IV	VI	VII = V-VI
2005	600.000	500.000			1.100.000	500.000	600.000
2006	700.000	470.500			1.170.500	470.500	700.000
2007	400.000	100.000			500.000		500.000
2008	600.000	190.000	310.000		1.100.000		1.100.000
2009	750.000	230.000	420.000		1.400.000	593.524	806.476
2010	700.000	130.000	420.000	413.370	1.663.370		1.663.370
2011	800.000	265.000	385.000		1.450.000		1.450.000
2012	860.000	250.000			1.110.000		1.110.000
2013	500.000	200.000			700.000		700.000
2014	150.000				150.000		150.000
2015	150.000				150.000		150.000
2016						-4.819.462,00	-4.819.462
<b>TOTAL</b>	<b>6.210.000</b>	<b>2.335.500</b>	<b>1.535.000</b>	<b>413.370</b>	<b>10.493.870</b>	<b>-6.383.486</b>	<b>4.110.384</b>
<b>CASH I MBETUR PAS KRYERJES SË TË GJITHA TRANSAKSIONEVE MË SIPËR</b>							<b>4.110.384</b>

**27.13** Në vijim të sa më sipër, lidhur me shkakun e ankimit *mbi verifikimin e saktësisë së deklaramit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar kursimet e deklaruara në formën e likuiditetit cash*, trupi gjykues konstaton sa më poshtë.

**27.13.1** Pasuria e deklaruar ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në formën e likuiditeteve *cash* (jashtë sistemit bankar) arrin vlerën totale prej 10493870 (dhjetë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë.

**27.13.2** Pjesa e mbetur e pasurisë së mësipërme, në vlerën prej 4110384 (katër milionë e njëqind e dhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lekë, si pasojë e pakësimeve të deklaruara për krijimin e depozitës bankare në emër të personit të lidhur në vitin 2006, krijimin e dy depozitave bankare në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të në vitin 2016, si dhe financimin e një pjese të çmimit të blerjes së një automjeti në vitin 2010, nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën e pasurisë (*vetting*) në asnjë lloj forme.

**27.13.3** Në periudhën e analizuar nga Kolegji, për vitet 2004-2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera, në vlerën prej 4367802 (katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dy) lekë.

**27.14** Lidhur me këtë situatë faktike, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të paplotë dhe të pasaktë të pasurive të tij në deklaratën e pasurisë (*vetting*) në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, me qëllim shmangien nga kontrolli, në kuadër të procesit të rivlerësimit, të pasurisë së tij në formën e likuiditetit *cash* (jashtë sistemit bankar), për shkak se rezultoi me pamundësi të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 28.** *Lidhur me çështjet e tjera të ngritura në ankim sipas paragrafit 11.10 më sipër në këtë vendim, pas shqyrtimit të tyre gjatë gjyqimit, trupi gjykues vlerëson se nuk u konstatuan problematika të cilat do të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit, lidhur me subjektin e rivlerësimit.*

*C. Mbi denoncimet e publikut të depozituara në Kolegj ndaj subjektit të rivlerësimit*

- 29.** Pranë Kolegjit, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj janë depozituar një sërë denoncimesh, si më poshtë vijojnë.
- Më datë 08.06.2018, u depozitua denoncimi i z. K.E. (ridepozituar më datë 27.02.2019 dhe datë 01.03.2019), objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
  - Më datë 25.07.2018, u depozitua denoncimi i z. A.E., objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
  - Më datë 25.07.2018, u depozitua denoncimi i z. G.T., objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
  - Më datë 26.09.2018, u depozitua denoncimi i z. P.R., në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë tregtare “{\*\*\*}” ShPK (ridepozituar më datë 01.03.2019), objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
  - Më datë 07.11.2018, u depozitua denoncimi i znj. S.M., objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
  - Më datë 06.12.2018, u depozitua denoncimi i znj. R.M., objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
  - Më datë 26.12.2018, u depozitua denoncimi i z. S.H. (ridepozituar më datë 27.03.2019), objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

- Më datë 03.04.2018, u depozitua një denoncim anonim, objekti i të cilit lidhej me kriterin e kontrollit të figurës.
- Më datë 19.04.2019, u depozitua denoncimi i znj. S.G., objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
- Më datë 23.04.2019, u depozitua denoncimi i znj. E.C., objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
- Më datë 30.04.2019, u depozitua denoncimi i z. F.Ç., objekti i të cilit lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

Depozitimi pranë Kolegjit i këtyre denoncimeve të publikut iu bë me dije edhe palëve në proces, të cilët nuk e panë të arsyeshme të mbanin qëndrime lidhur me to.

**29.1** Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre denoncimeve të depozituara gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, trupi gjykues konstatoi se ato lidheshin me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për të cilin Komisioneri Publik nuk kishte paraqitur ankim, si dhe vlerësoi se këto denoncime nuk përmbanin fakte apo rrethana, të cilat mund të përbënin provë në këtë proces gjyqësor, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, për shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit Edmond Islamaj.

30. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik, për kriterin objekt ankimi, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, akteve të administruara nga hetimi gjyqësor i kryer nga Kolegji, dëgjimit të parashtrimeve të palëve në proces, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, sipas parashikimeve në fuqi në kohën në të cilën kanë ndodhur faktet e provuara gjatë hetimit,

**trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,  
bazuar në analizën e mësipërme, arrin në këto konkluzione:**

31. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të paplotë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
32. Për rrjedhojë, kërkimi i Komisionerit Publik për ndryshimin e vendimit nr. 22, datë 07.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet pranuar.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pika 3, si dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 22, datë 07.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 22.05.2019.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Luan DACI**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, paraqes më poshtë mendimin tim paralel, lidhur me një aspekt të vendimit të marrë nga shumica për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për sa i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj.
2. Së pari, nuk jam dakord me metodologjinë e përdorur nga shumica e trupit gjykues të kësaj çështjeje për përlogaritjen e standardeve të jetesës, që më pas ka shërbyer si bazë e vendimit të shumicës. I vetmi institucion zyrtar, i ngarkuar me ligj për të përlogaritur standardet e jetesës në Republikën e Shqipërisë, për të gjitha subjektet që janë funksionarë publikë, përfshirë edhe subjektet e rivlerësimit kalimtar, vit pas viti, është Instituti i Statistikave (INSTAT).
3. Siç rezulton nga korrespondenca zyrtare mes ILDKPKI-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, (konkretisht shkresa me nr. prot. {\*\*\*}, datë 04.03.2019, e ILDKPKI-së, në përgjigje të shkresës me nr. prot. {\*\*\*}, datë 28.02.2019, e Kolegjit), Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë ka referuar rregullisht dhe zyrtarisht treguesit statistikorë të konsumit mujor dhe vjetor për familje dhe për frymë, për periudhën kohore nga viti 2000 në vitin 2018. Korrespondenca në fjalë shtjellon me hollësi se si mbi bazën e këtyre të dhënave, janë përlogaritur nga ILDKPKI-ja shpenzimet e jetesës për të gjithë zyrtarët që deklarojnë pasurinë në Republikën e Shqipërisë, që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2004, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” . Me fjalë të tjera, përlogaritja nga ILDKPKI-ja e shpenzimeve të jetesës për subjektet deklaruese ka qenë e bazuar në të dhënat e INSTAT-it në vitin përkatës.
4. Në vlerësimin tim, metodologjia e zgjedhur nga shumica e trupit gjykues, që bazohet në marrjen e të dhënave të një viti të caktuar, në rastin konkret, sipas modelit “Njësi Ekonomike Familjare” , përftuar sipas disa treguesve specifikë që lidhen me vendin dhe arsimin e kryefamiljarit, të publikuar në faqen zyrtare të INSTAT-it dhe shtrirja e të dhënave të marra nga publikimi në faqen e internetit për një vit të caktuar (2007) në vitet e tjera, në kundërshtim me vetë korrespondencën e INSTAT-it, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe kapërcen tagrat e një gjykate. Si rrjedhojë, përftohet një analizë financiare e pabazuar në aktet ligjore në fuqi dhe në pritshmëritë që qytetarët kanë ndaj një organi shtetëror.<sup>29</sup> Mbështetja, për efekt kontrolli të deklarimit ndër vite, nga gjyqtarët dhe prokurorët në të dhëna tabelare të ndryshme nga standardi institucional, përcjellë nga INSTAT-i e që zbatohen njëtrajtshëm për gjithë individët subjekte të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2004, bie ndesh me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, të parashikuara ndër të tjera edhe nga nenit 17 i Kodit të Procedurave Administrative (ligji nr. 49/2015) sipas të cilit:  
“[···] 2. Palët që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë. [···]”
5. Vendimi i shumicës së trupit gjykues, që përlogarit shpenzimet e jetesës për gjyqtarët dhe prokurorët bazuar në kritere të ndryshme nga ato të zbatuara për gjithë funksionarët publikë, pa identifikuar karakteristika objektive që lidhen me vetë këtë kategori funksionarësh publikë, përbën një trajtim të diferencuar të pajustificuar dhe, si rrjedhojë, bie ndesh me dispozitën e sipërcituar. Kjo qasje bie ndesh edhe me parimin e *pritsmërive legjitime* të së drejtës administrative, sipas të

<sup>29</sup> Për doktrinën e pritshmërive legjitime shih ndër të tjera:

<https://www.oxfordreference.com/view/10.1093/oi/authority.20110810105248783>, ose:

[https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule\\_of\\_Law\\_Check\\_List.pdf](https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule_of_Law_Check_List.pdf)



cilit autoritet publike mund të privojnë një individ nga një përfitim (në këtë rast, karriera e magjistratit) vetëm pasi të ndiqet një procedurë e parashikueshme. Nëse autoritetet publike nuk veprojnë në përputhje me pritshmëritë legjitime, të bazuara edhe në praktika të përdorura më parë nga vetë autoritetet publike, kjo përbën shkelje të parimeve të shtetit të së drejtës për parashikueshmëri dhe siguri. Ky parim gjen zbatim jo vetëm referuar akteve ligjore dhe nënligjore, por edhe vendimeve të veçanta të autoriteteve publike<sup>30</sup>.

6. Për të gjitha këto shkaqe, analiza financiare që kryhet për subjektet e rivlerësimit në funksion të rishikimit të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet të mbështetet vetëm në të dhënat zyrtare të identifikuara, të dokumentuara dhe të përcjella nga INSTAT-i vit pas viti. Është detyrë bazike e gjykatës ta bazojë analizën financiare në të dhëna zyrtare të mirëpërcaktuara dhe të njohura, pavarësisht nëse kjo përbën apo jo bazë kërkimi të shprehur nga vetë subjekti. Për të njëjtat shkaqe, edhe nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit zbaton një standard të ndryshëm nga ai zyrtar, në bazë të nenit F të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit është përgjegjësi e Kolegjit të vendosë vetë në lidhje me çështjen, Kolegji duhet të korrigjojë gabimet e kryera, përfshirë edhe çdo konstatim fakti që vlerësohet ndryshe nga ai i konstatuar në shkallë të parë.
7. Zbatimi i standardit zyrtar në fuqi për gjithë kohëzgjatjen e detyrimit të deklarimit të pasurisë nga subjektet nuk mund të jetë i kushtëzuar nëse subjekti ka kërkuar apo jo shprehimisht përdorimin e standardit zyrtar për një periudhë kohore apo në tërësi. Një kusht i tillë bie ndesh me vetë konceptin e standardit zyrtar. Së fundmi, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka përgjegjësi të zbatojë standardet e mirënjohura zyrtare, pavarësisht nga efekti që ka zbatimi i tyre mbi subjektet e rivlerësimit.
8. Vetëm duke iu përmbajtur standardit zyrtar të mirëpranuar dhe të zbatuar ndër vite, shmangen pasojat që sjell cenimi i sigurisë juridike të subjekteve të rivlerësimit, të cilat janë vetëm një pjesë e mijëra funksionarëve të tjerë publikë që i janë nënshtruar deklarimit dhe kontrollit të pasurisë prej vitit 2003 në Republikën e Shqipërisë.

## **GJYQTARE**

### **REZARTA SCHUETZ**

*nënshkrimi*

---

<sup>30</sup> *Shih poshtëshënimin nr. 1, po aty, faqe 27.*